GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7523 E mërkurë 9 Maj 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

Evropa, politika dhe populizmi

Tani, kur asnjë vit nuk na ndan nga zgjedhjet e reja të Parlamentit Evropian, veç problemeve dhe tensioneve të njohura dy dhe shumëpalëshe, reformimit ... Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga NADIE AHMETI

Diplomacia "jounike" e Kosovës

Politika e jashtme e Kosovës po reflekton disa ndasi në qëndrime rreth çështjeve të ndryshme, të cilat sipas analistëve politikë, mund të sjellin pasoja ... Vijon në faqen 21

Reagon Berisha: Një kriminel më shumë

Izet Haxhia në Shqipëri, avokati: Rihapja e dosjes "Hajdari", e ligjshme

I dënuari me 25 vite burg ekstradohet nga Turqia. Fran Dashi: Flet në kohën e duhur

TIRANE - Izet Haxhia, ish-truproja i Sali Berishës, i akuzuar për vrasjen e Azem Hajdarit u ekstradua mbrëmjen e djeshme nga Turqia. Haxhia u nis nga Stambolli me avion të "Turkish Airlines", ndërsa zbriti në Rinas rreth orës 20:00. Pas mbërritjes në Rinas, Haxhia u dërgua fillimisht në Drejtorinë e Policisë së Tiranës ... Në faqen 8

CAKTOHET FORMULA E AUTOMJETEVE SIPAS VITIT TE PRODHIMIT, SA DO PAGUAJME

NDRYSHON TAKSA VJETORE PER MAKINAT E PERDORURA

Udhëzimi i Ahmetajt, zbardhet tabela me të gjithë koeficientët. Shembujt konkretë për llogaritjen. Vendimi hyri në fuqi më 8 maj

(Në foto) Makina në Tiranë Në faqet 6-7

MINISTRJA: DITE E ZEZE

S'shkarkoi 3 gjyqtarët, Meta kundër KLD: Shkelje flagrante, nevojë për institucione të reja

Në faqen 3

SHKAKU I INCIDENTIT

Sherr me thika para Presidencës, plagosen 4 studentë, arrestohet 20-vjeçari Henri Karaj

Në faqen 8

RREFEHET HERION MUSTAFARAJ

Nga "Beni ecën vetë", te divorci dhe planet për të sjellë 'show'-n 'Jashtë nga Broadway'

Suplement

KOMPETICIONI

Eugent Bushpepa mahnit Lisbonën, kualifikohet në finalen e Eurosong

Në faqen 18

LETER EDHE METES

3 bashki të Veriut peticion Ramës: Anulo taksën e rrugës së Kombit

Në faqen 8

Rimbursimi/ Deklaruan uljen e çmimit të barnave, Urdhri i Farmacistit reagon ashpër

ISKSH: Shtuam 36 barna. Toma: Ja ilaçet që mungojnë

Presidentja e UFSH-së: ISKSH përjashtoi nga skema shumë pacientë

Nga VOLTIZA DURO

Futja në fuqi e listës së re të barnave të rimbursueshme është shoqëruar me reagime të forta nga rrjeti farmaceutik në Shqipëri, i cili ka hedhur akuza për shkelje ligjore. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", presidentja e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Diana Toma tregon se farmacistët nuk janë njoftuar paraprakisht për futjen e listës së re të barnave në fuqi, çka bie në kundërshti me ligjin, e njëkohësisht sjell ... Në faqen 9

INTEGRIMI

RAPORTIMI NË KUVEND

Ministri i Jashtëm raporton në Kuvend, PD e bojkoton, LSI e kritikon

Negociatat, Bushati: U kërkova vendeve skeptike të sjellin misione verifikuese

"Opozita si fanti spathi, flet çfarë të dojë"

Darina Tanushi

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati bëri të ditur se u ka kërkuar vendeve skeptike të BE-së që të sjellin në Shqipëri misione për të verifikuar ato që ka konstatuar Komisioni Evropian në raportin e tij të rekomandimit për Shqipërinë. Ministri foli dje në Komisionin parlamentar për Politikën e Jashtme, ku ishte thirrur për të raportuar. Në këtë dëgjesë me ministrin Bushati munguan deputetët e PD-së, por jo të LSI-së. "Personalisht u kam bërë ftesë të gjitha vendeve që nuk janë të kënaqur me raportin e Komisionit Evropian të sjellin misione të ekspertizës në Shqipëri për të bërë verifikimet përkatëse", u shpreh Bushati. Nisur edhe nga takimi i fundit i grupit të deputetëve holandezë me deputetët shqiptarë, Bushati kritikoi qëndrimin e opozitës. "Por, mos mendoni se një grup deputetësh që vijnë nga një vend, ku qeveria e tyre mbahet vetëm me një votë në këmbë, ku kanë skepticizëm shumë të madh për një pjesë shumë të madhe të vendeve të Evropës Jugore, që janë edhe themelueset e BE-së, të shkojnë me një optimizëm të madh kur mund të dëgjojë dikë që futet si fanti-spathi në një drekë, vë kasetën dhe thotë gjëra që ka qejf për të thënë", tha më tej Bushati. "Është po Partia Demokratike, që po t'u referohemi vetëm fakteve, pa dashur për të bërë analizë politike, ka përgjegjësi për vonesën në këtë proces", shtoi ministri. Në përgjigje të deputetëve skeptikë të LSI-së, Bushati tha se qeveria është në komunikim të vazhdueshëm me vendet anëtare të BE, duke shtruar para tyre fakte e duke i bindur se Shqipëria është gati t'i bashkohet familjes europiane. "Ju thoni rekomandim pozitiv pa kushte, por disa nga vendet anëtare ju e dini mirë që dinë të lexojnë edhe kushtet brenda rekomandimit të dhënë nga Komisioni Europian", u shpreh ish-ministrja e Integrimit, Klajda Gjosha. Ndërsa, përgjigja e ministrit ishte: "Nuk ka kushte brenda rekomandimit, ky është një rekomandim i qartë, i pakushtëzuar. Ne jemi në kontakte të vazhdueshme me të gjitha vendet anëtare. Nuk besojmë që ky do të jetë një proces i lehtë. Vendet anëtare do të shqyrtojnë raportin, do të shqyrtojnë strategjinë e zgjerimit. Ne jemi në kontakte të vazhdueshme me të gjitha vendet anëtare, nuk besojmë se do të jetë proces i lehtë. Nuk diskutohet që para nesh është një e përpjetë, sidomos sa i përket gamës së të drejtave dhe detyrimeve që shtrohen, por ne mbrojmë pikëpamjen kur jemi në kushtet e një kapitulli të ri, që do t'i japë mundësi Shqipërisë të bëjë më shumë reforma, të përmirësojë standardet dhe do t'u krijojë mundësi vendeve anëtare për të influencuar pozitivisht zhvillimet e brendshme në Shqipëri", vijoi ministri. Sipas tij, "ky proces ka marrë një kohë të madhe, në disa raste të paarsyeshme, për shkaqe që ne i dimë mirë. Shqipëria ka aplikuar në prill 2009 për t'u anëtarësuar në BE dhe vetëm pas 9 vitesh Shqipëria ka marrë rekomandimin e parë pa kushte për të filluar bisedimet". Në lidhje me negociatat me shtetin grek, ministri informoi se raundi tjetër i bisedimeve do të zhvillohet javën e ardhshme në Athinë. "Për pak ditë, jo këtë javë, por tjetrën do të jetë raundi i ardhshëm në Athinë. Duhet të jemi realistë. Nuk është një proces i lehtë, por nga ana tjetër nuk ka më asnjë të panjohur qoftë sa i përket Greqisë, qoftë për ne, sa u përket pretendimeve apo gabimeve që janë bërë në të shkuarën", tha ministri Bushati. Ai falënderoi Greqinë që të premten do të mbledhë disa nga vendet për të lobuar në mbështetje të Shqipërisë.

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati

NEGOCIATAT ME GREQINË

"Për pak ditë, jo këtë javë, por tjetrën do të jetë raundi i ardhshëm në Athinë. Duhet të jemi realistë. Nuk është një proces i lehtë, por nga ana tjetër nuk ka më asnjë të panjohur qoftë sa i përket Greqisë, qoftë për ne, sa u përket pretendimeve apo gabimeve që janë bërë në të shkuarën", tha ministri Bushati.

Presidenti Ilir Meta gjatë një mbledhjeje të KLD-së

Ministri i Jashtëm mbledh paraardhësit për javën e Evropës: Bashkim brenda vetes

Për Shqipërinë, projekti europian është në thelb një projekt bashkimi brenda vetes". Kështu është shprehur ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati në konferencën e zhvilluar ditën e sotme me Delegacionin e BE-së në Shqipëri: "Së bashku drejt Bashkimit Evropian. Njohja e përvojës së shkuar dhe krijimi i partneriteteve për të ardhmen". Konferenca është konceptuar në dy panele, "Njohja e përvojës së shkuar" dhe "Krijimi i partneriteteve për të ardhmen". Sipas Bushatit, projektin europian shumica dërrmuese e shqiptarëve e

shohin si projektin e paqes, sigurisë, mirëqenies, por mbi të gjitha, e shohin si projektin e një qeverisjeje demokratike për ta. Për kreun e diplomacisë shqiptare, projekti europian përkon jo vetëm me modernizimin dhe transformimin e shoqërisë sonë, por edhe me konsolidimin e identitetit tonë europian si komb. Ish-ministrat e Shtetit për Integrimin dhe ish-ministra Integrimi të ftuar në këtë tryezë, si Sokol Nako, Paskal Milo, Ermelinda Meksi, Majlinda Bregu dhe Klajda Gjosha diskutuan mbi përvojën e tyre në rrugën e integrimit europian dhe ndanë bindjen se ky proces është i rëndësishëm për të gjithë shqiptarët, përtej çdo përkatësie politike.

KODHELI

Kryetarja e Komisionit të Jashtëm merr mbështetjen e Irlandës për në BE

Kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme, znj. Mimi Kodheli priti në një takim kortezie ambasadoren e Irlandës në Tiranë, Orla O'Hanrahan (rezidente në Athinë). Ambasadorja irlandeze theksoi mbështetjen e vazhdueshme të vendit të saj ndaj procesit të integrimit evropian të Shqipërisë. "Besoj se Irlanda do ta konfirmojë këtë qëndrim si dhe pozicionin e saj në favor të rekomandimit të pakushtëzuar të Komisionit Europian për hapjen e negociatave edhe në samitin midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor të Sofjes", - tha ajo. Kodheli shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe theksoi se rekomandimi i Komisionit është tregues i progresit të reformave, që vendi ka ndërmarrë dhe përmbushjes së detyrave në zbatimin e prioriteteve të vendosura për integrimin evropian. Kryetarja e Komisionit të Jashtëm bëri më tej një prezantim të politikës së jashtme të Shqipërisë dhe rolit të saj në rajon si faktor i rëndësishëm i paqes dhe stabilitetit. Gjatë takimit bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e intensifikimit të marrëdhënieve midis dy vendeve dhe nevojën e identifikimit të fushave të bashkëpunimit me interes reciprok, me fokus të veçantë tek turizmi dhe shkëmbimet në fushën e kulturës dhe edukimit.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Përplasja, ministrja Gjonaj sulmon KLD: Ditë e zezë, mbron interesat personale të gjyqtarëve

Nuk shkarkoi 3 gjyqtarët, Meta kundër KLD: Shkelje flagrante

Presidenca: Keqardhje! Nevojë për institucione të reja

Kreu i Shtetit Ilir Meta

ETILDA GJONAJ
"KLD si një organ kolegjial ka dështuar në garantimin e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe është kthyer në një strukturë mbrojtëse të interesave personale të gjyqtarëve në dëm të interesit publik. Një arsye më shumë për ta vazhduar me vendosmëri reformimin rrënjësor të sistemit aktual të drejtësisë".

PRESIDENCA
"Presidenti ka mbështetur kërkesën e ministres Gjonaj për shkarkimin e gjyqtarëve, por vendimi i marrë me shumicë votash tregon se është e nevojshme ngritja dhe funksionimi sa më parë i organeve të reja të sistemit të drejtësisë, që janë parashikuar nga reforma në drejtësi",- deklaroi zëdhënësi, Tedi Blushi.

Valentina Madani

Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj dënoi dje mos shkarkimin nga KLD të tre gjyqtarëve, Petraq Curri i Durrësit, Ergys Selmani i Fierit dhe Ken Dhima i Administratives së Vlorës, pavarësisht kërkesës nga ana e ministrisë. "Ditë e zezë për drejtësinë" e quajti ministrja e Drejtësisë ditën e hënë kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi të mos shkarkojë asnjë nga 3 gjyqtarët e propozuar nga ministrja për shkelje. "Këshilli i Lartë i Drejtësisë mbajti mbledhjen e radhës ku u rrëzuan tri propozimet e mia, për shkarkimin e tre gjyqtarëve, të cilët nga raportet e inspektimit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë rezultonin me shkelje të rënda të ligjit, diskrediteuese për figurën dhe pozitën e gjyqtarit", deklaroi zj.Gjonaj. Sipas ministres gjyqtarët kishin kryer shkelje të rënda. Gjonaj e quajti vendimin e KLD të pajustifikueshëm dhe e akuzoi se është kthyer në një strukturë mbrojtëse të interesave personale të gjyqtarëve. "E djeshmja (e hëna) ishte një ditë e zezë për këtë Këshill, që nxori në pah sfidën e madhe që kemi përpara për të përmbysur sistemin e kalbur të drejtësisë! Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si një organ kolegjial, ka dështuar në garantimin e llogaridhënies së gjyqtarëve, dhe është kthyer ne një strukture mbrojtëse të interesave personale të gjyqtarëve në dëm të interesit publik. Një arsye më shumë për ta vazhduar me vendosmëri reformimin rrënjësor të sistemit aktual të drejtësisë dhe për t'u ndarë me thikën e operacionit të spastrimit të sistemit, nga kasta e korruptuar që e ka mbajtur atë peng për më shume se çerekshekulli! Unë kam besim që me zbatimin pa kompromis të reformës në drejtësi, vendime si ato të djeshmet, do të mbeten pjesë e historisë së padenjë të një sistemi, të cilit, po i vjen fundi dhe nuk do të përsëriten më në të ardhmen", tha zj.Gjonaj. Presidenca reagoi për vendimmarrjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të datës 07.05.2018, mbledhje ku u rrëzuan propozimet e ministrit të Drejtësisë, për shkarkimin nga detyra të disa prej gjyqtarëve. Sipas Presidencës, Kreu i Shtetit Ilir Meta e quan shkelje flagrante vendimin e KLD-së për të mos shkarkuar tre gjyqtarët e propozuar nga ministrja Etilda Gjonaj. Zëdhënësi i presidentit, z.Tedi Blushi i pyetur lidhur me reagimin që ka ky institucion për vendimmarrjen e KLD-së, e cila drejtohet nga kreu i shtetit nënvizoi se: kreu i shtetit shprehu keqardhjen për mos miratimin e vendimeve. Blushi vuri në dukje se presidenti ka mbështetur kërkesën e ministres Gjonaj për shkarkimin e gjyqtarëve, por vendimi i marrë me shumicë votash tregon se është e nevojshme ngritja dhe funksionimi sa më parë i organeve të reja të sistemit të drejtësisë që janë parashikuar nga reforma në drejtësi". Presidenti i Republikës, z.Ilir Meta, që prej marrjes së detyrës si Kryetar i KLD-së, ashtu si dhe ditën e djeshme ka mbështetur në vijimësi të gjitha propozimet e Ministrisë së Drejtësisë (propozime të ish-Ministrave të Drejtësisë, apo Ministres aktuale Gjonaj) për procedimin disiplinor dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve, kërkesa këto aktuale, apo kërkesa të mbartura dhe të pashqyrtuara nga KLD-ja. Mbledhja e ditës së djeshme (e së hënës) dhe vendimmarrja e shumicës së anëtarëve të KLD-së për procedimin e gjyqtarëve tregon edhe njëherë nevojën ekstreme që ka vendi, për ngritjen dhe funksionimin sa më parë të organeve të reja të sistemit të drejtësisë që janë parashikuar nga reforma",-deklaroi z.Blushi

PD, Duma: Duhet ta ndalet pastrimi i parave të zeza në Shqipëri

Deputetja e PD-së, Grida Duma, foli dje për mundësinë e çeljes së negociatave me BE, dorëheqjen nga mandati të ish-ministrit Saimir Tahiri dhe aksionet e opozitës. Duma në studion e News 24 akuzoi qeverinë që po shkatërron ekonominë e vendit me pastrimin e parave të drogës. "Fatkeqësia më e madhe është se nëse vazhdon e nuk ndalohet paraja e trafikimit të drogës, atëherë vend për ekonomi të pastër nuk do të ketë më. Njerëz që duan të jetojnë normalisht nuk do ketë më. Duhet ta ndalet pastrimi i parave të zeza në Shqipëri. Duhet të kalojmë në ekonomi konkurruese për sa i përket bujqësisë, një sektor që mund ta përdornim për mirë në Shqipëri",-u shpreh Duma. Ajo përmendi se 8 deputetët e ardhur nga Holanda në Shqipëri, e dinë mirë situatën në vend, dhe prandaj janë skeptikë në lidhje me çeljen e negociatave. Për sa i përket dorëheqjes së Tahirit nga mandati i deputetit, nëse do të ndikojë në hapjen e negociatave, deputetja e djathtë tha se ishte një veprim që duhet të ndodhte kohë më parë. "Që ishte e shtrënguar kjo nuk diskutohet. Ne e dimë shumë mirë që, nëse akuza të tilla vijnë nga organet e hetimit të një vendi anëtar të BE, si Italia, e cila nuk hap çështje kot, kjo duhet të ndodhte me kohë. Tahiri i foli "Shefit" me gjuhë mafiozësh. Tahiri është përdorur. Kemi parë kode mafioze në qeverisje. Dorëheqja mendoj se ishte lëvizje e vonuar"- tha Duma.

"TALASEMISË", META DHURON GJAK

Në Ditën Botërore të Talasemisë, Presidenti Meta dhe stafi i tij dhuruan gjak për të prekurit nga kjo sëmundje. Meta i akordoi shoqatës së Talasemikëve Shqiptarë, titullin: "Për merita të veçanta civile". "Të gjithë së bashku të mposhtim indiferencën dhe të ndërtojmë solidaritetin për të dhuruar gjak për ata që kanë nevojë. Shoqëria jonë ka nevojë të nxisë veçanërisht vullnetarizmin në dhurimin e gjakut", - tha z.Meta

"Veting" zgjedhjeve, PD: Të nxirren të vërtetat e manipulimit

Pas sistemit gjyqësor, kryetari i PD-së të Durrësit kërkon që vetingu të shtrihet edhe në proceset zgjedhore. Për Xhaferrin, deformimi i votës është burimi i keqqeverisjes dhe problematikave që kalon vendi, ndaj sipas tij ky proces do të nxirrte të vërtetën e manipulimit dhe përdorimit të të fortëve nga maxhoranca aktuale. Xhaferri ka nisur një tur takimesh në Durrës, në kuadër të riorganizimit të degës lokale. Gjatë një takimi në kuadër të riorganizimit të selisë blu të Durrësit në fshatin Katund i Ri, Xhaferri tha se vetingu i zgjedhjeve është nevojë parësore sipas tij për Shqipërinë, krahas rivlerësimit të prokurorëve, gjyqtarëve dhe policëve. "Ky është vetingu që burojnë të gjithë vetingjet e tjera, vetingu i zgjedhjeve do të nxjerrë lakuriq si i kanë

Deklarata

"Ne do bëjmë të pamundurën si PD, që qëndrimi ynë është pro hapjes së negociatave. Filozofia e ekonomisë së bashkuar vazhdon edhe sot. Çfarë duhet të bëjmë ne që qeveria të rrisë llogaridhënien që duhet t'i japë qytetarëve", tha z.Duma.

blerë, si i kanë përdorur të fortët dhe çfarë strukture ka adoptuar Edi Rama dhe Vangjush Dako në Durrës",- tha z.Xhaferri. Xhaferri ishte i ashpër në autokritikën për funksionimin e degës së PD në Durrës dhe i drejtpërdrejtë me mbështetësit, të cilëve u kërkoi që të dalin nga tulatja në përballjen me pushtetin kriminal siç e cilësojnë demokratët qeverinë e majtë. "I ngelte qejfi njerëzve se pse nuk vendoseshin komisionerë dhe të arrijmë ne që të mos gjejmë komisionerë, kjo ka të bëjë me gabimet tona",-tha z.Xhaferri. Duke renditur arsye pse sipas tij durrsakët mund të kenë 100 arsye për të mos votuar PS, Xhaferri kërkoi nga strukturat që t'u paraqesin 101 arsye të tjera pse duhet të votojnë PD në zgjedhjet e vitit të ardhshëm. "Ne duhet të përgatisim 101 arsye pse duhet të na votojnë ne",-tha ai. I pranishëm në takim, deputeti demokrat, Oerd Bylykashi, i cili e vuri theksin te zhvillimet më të fundit në çështjen Tahiri dhe pritshmëritë për çeljen e negociatave.

QEVERIA
LLOGARIDHËNIA

Kryeministri debaton me qytetarët në Laç, deklarata për Saimir Tahirin

Akuzat e PD, Rama: Maskarenj që u bien daulles, 70% e fondeve shkojnë në veri

"Tani që lamë borxhet e Saliut, jemi gati për investime"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama ka debatuar dje në Laç me disa banorë për taksat, për projektet e parashikuara për veriun, shëndetësinë etj. Ai iu është përgjigjur të gjitha kritikave, madje edhe me tone të larta. Duke iu përgjigjur një qytetari që i tha se më shumë investime ka bërë në jug se sa në veri, Rama u shpreh se se nga projekti 1 miliard për rindërtimin e rrugëve, 70% e investimeve do të shkojnë në veri, për rrugë që do të përfundojnë brenda këtij mandati. Rama mohoi të ketë rritje taksash për drita e ujë. "Taksa drita dhe ujë? Nuk janë taksa, janë mallra që blihen dhe paguhen. Dhe sigurisht kur nuk i ke paguar përpara dhe fillon t'i paguash, të duket qamet i madh. Shtresat më korrekte me pagesën e dritave në Shqipëri kanë qenë pensionistët dhe personat me aftësi të kufizuar, dy pikat më të dobëta të të gjithë organizmit shoqëror. Ka ndonjë që mund të më thotë se ka dhe më pak se sa ç'kanë këto dy kategori? S'ka si ta thotë. Kanë paguar drita pensionistët pa pushim, pa ndërprerje, se erdhi Saliu ,se iku Saliu, se u përmbys shteti më '97, ata kanë qenë paguesit më korrektë të dritave. Dritat nuk janë taksa, janë mall. Uji s'është taksë. Është tipike që në Shqipëri ankohen për rritjen e taksave ata që s'paguajnë taksat", sqaroi kryeministri. Këtij qytetari Rama iu drejtua në një moment: "Ulu mo zotëri tani, ti s'paguan asnjë taksë, ti e the vetë. Unë nuk mendoj që ti duhet të paguash taksa. Ti je pa punë dhe s'paguan taksa. Dhe çon dorën që të janë rritur taksat, ti s'paguan asnjë taksë. Rrej, rrej, rrej, krijohet një psikozë sikur kjo qeveri vetëm rrit taksa. Jo! Ne kemi rritur vetëm dy taksa. Ekspertët e 'Facebook'-ut thonë ç'janë këto taksa me këto paga, por kush merr rrogë deri në 30 mijë lekë, e ka taksën zero. Biznesi i vogël nga 5 deri në 8 milionë xhiro paguan 5 për qind, nën këtë zero. Kemi rritur taksën e karburantit", sqaroi kryeministri. "E dëgjuat historinë e rrugës Thumanë-Milot. Ka që në vitin 2010 që ka filluar një rotondë. Ka që në 2009 që ka nisur një copë tjetër dhe rruga është ende e papërfunduar. Dikush mund të thotë ti s'ke ardhur dje, ke ardhur para 4 vitesh e gjysmë në qeveri, pse se përfundove ti? Rrugët u lanë rrugëve, sepse Saliu thotë kemi bërë 10 mijë kilometra. Me vizoren e Saliut, shifrat duhen marrë me lekët e vjetra, por sidoqoftë, qeveria paraardhëse ka bërë tendera shumë më tepër se sa qeveria jonë. Po të numërosh sa kilometra tendera ka bërë qeveria e Saliut janë shumë, po të shkosh t'i shohësh në terren në 2013 sa ishin realizuar, unë po ju them që ne kemi ndërtuar më shumë kilometra se sa kishin ndërtuar ata. Nuk i përfunduam dot, sepse ishin hapur tendera duke hapur një gropë të madhe borxhesh - u shpreh Rama. - Tani që kemi shlyer borxhet, jemi gati për programet e investimeve", tha ai. E duke i dhënë përgjigje banorit që i tha se projektet më të shumta janë në jug, Rama tha: "I vetmi projekt i pjesës së rrugëve për jugun, është ai nga dalja e Vlorës deri në Llogara, nga ana financiare është segmenti më pak i kushtueshëm. Më shumë se 70% e fondeve shkojnë nga Tirana e lartë, kjo është për maskarenjtë që i bien kësaj daulleje". Kryeministri Edi Rama akuzoi opozitën se sulmon çdo punë të qeverisë, duke e lidhur me para të drogës dhe krimit. Gjatë një takimi me banorë të Laçit, Rama tha se pikërisht kjo ishte edhe arsyeja për nisjen e turit të llogaridhënies. Për ta bërë edhe më të besueshme tezën e tij, Rama tha se edhe nëse largohet nga salla në atë moment, opozita do të thotë se shkoi të takojë kryekriminelin e zonës për çështjen "Tahiri". "Se nuk diskutohet se këtu çfarëdo që të bësh e bën me paratë e krimit, paratë e drogës, e bën për këtë e për atë. Edhe nëse unë ju kërkoj leje për një moment të dal pak jashtë, thonë shkoi të kontaktojë me një nga kriminelët më të mëdhenj të zonës për çështjen e Saimir Tahirit, nuk diskutohet. Kjo është arsyeja e kësaj fushate, për të thënë ca të vërteta siç janë", u shpreh Rama.

Kryeministri Edi Rama

SAIMIR TAHIRI
"Nuk diskutohet se këtu çfarëdo që të bësh, e bën me paratë e krimit, paratë e drogës; e bën për këtë e për atë. Edhe nëse unë ju kërkoj leje për një moment të dal pak jashtë, thonë shkoi të kontaktojë një nga kriminelët më të mëdhenj të zonës për çështjen e Saimir Tahirit, nuk diskutohet. Kjo është arsyeja e kësaj fushate, për të thënë ca të vërteta siç janë", u shpreh dje Rama.

RAMA KËRCËNON ME LARGIM NGA PUNA DREJTORIN E HIPOTEKËS

Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi në Laç me qytetarët ka kërcënuar drejtorin e Hipotekës, pasi tha se nëse ai nuk zgjidhte problemin e qytetarit deri nesër pasdite, do t'i niste lajmin që nuk do ishte pozitiv.

Debati

Qytetari: Kam një problem me shtëpinë se nuk më hipotekojnë. Shtëpinë më thonë që e kam me probleme.

Rama: Është këtu ai drejtori i Hipotekës?

Drejtori i Hipotekës: Ka një mbivendosje në hartë.

Rama: Nesër në mëngjes zotëria do vijë që të të takojë. Do çosh ekspertët të shikojnë, shko zgjidhe dhe jepi certifikatën. Dhe deri pasdite duhet që të zgjidhet dhe të më vijë lajmi mua. Po nuk erdhi lajmi nga ty tek unë, do vij lajmi nga unë tek ti dhe nuk do jetë pozitiv.

Drejtori i Hipotekës: Po, në rregull.

Nga protestat për Rrugën e Kombit

Ministrat e Brendshëm dhe të Drejtësisë së BE do të mblidhen në tetor në Tiranë

Tirana do të presë në tetor ministrat e Brendshëm dhe të Drejtësisë të Bashkimit Europian dhe të Ballkanit Perëndimor. Lajmin e bëri të ditur ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj pas vizitës që pati në Austri. Në një postim në "Twitter", Xhafaj tha se ky takim do të mbahet në Tiranë gjatë presidencës austriake të BE. "Austria është një ndër mbështetësit me aktivë të integrimit tonë në Evropë", tha ministri Xhafaj. Në Vjenë, Xhafaj u takua me kryetarin e Parlamentit Austriak, Wolfang Sobotka dhe homologun e tij; ministrin e Brendshëm, Herbert Kickl. "Bashkëbisedim shumë konstruktiv e i frytshëm me kolegun austriak. Projekte të përbashkëta në zhvillim", shprehet ministri Fatmir Xhafaj.

Avokati: Qeveria, sllave e tregtisë parazite

Ngjela sulmon Ramën: Me korrupsion bleu krizën e PS-së dhe u bë kryetar

Avokati Spartak Ngjela, teksa komentoi reformën në drejtësi, nuk i kurseu sulmet dhe etiketimet për kryeministrin Edi Rama. Përmes një statusi në "Facebook", Ngjela tha se Shqipëria do të hyjë në BE si vend anëtar me të drejta të barabarta dhe se shprehet optimist që vendi do të ketë një qeveri të moralshme. Ngjela tha se Rama përmes korrupsionit bleu Partinë Socialiste dhe u bë kryetari. "Asnjëherë nuk ka pasur një qeveri europiane në Shqipëri. Deri tani koha nuk iu ka dhënë shqiptarëve mundësi të kenë një qeveri të nivelit të lartë. Por, ka edhe diçka: pa një pushtet gjyqësor të drejtë dhe të pavarur, një vend kurrë nuk mund të ketë një qeveri me nivel të lartë profesional dhe ideor", u shpreh dje Ngjela. "Kjo e sotmja, si gjithë të tjerat, është një qeveri që vetëm kërkon para për mbijetesën e vet të pushtetit dhe shkatërron tregun me klientelën e vet. Qeveria 'Rama' është sllave e tregtisë parazite dhe shkatërruese e investimit shqiptar. Nuk kupton dot asgjë, në një kohë që Shqipëria po vdes nga varfëria", komentoi avokati. "Pyetja e drejtpërdrejtë që ngrihet këtu është kjo: Çfarë përfaqëson kryeministri që drejton administrativisht sot Shqipërinë? Asgjë. Ky është një individ që pasi gënjeu Ilir Metën me përrallë, mori të drejtonte Bashkinë e Tiranës. Pasi manipuloi dy herë zgjedhjet me skemën e heqjes së zgjedhësve të PD nga listat zgjedhore, dhe pasi bleu dhe Saliun, shkatërroi Tiranën në një rrugë klienteliste. Më pas, me korrupsion dhe leje ndërtimi bleu krizën e Partisë Socialiste dhe u bë kryetar i saj", tha Nagjela.

LETRA

Këshilltarët Bashkiakë të Kukësit, Hasit dhe Tropojës kërkojnë lirimin e 4 kuksianëve, të cilët mbahen në burg, pasi u vunë në pranga për sulmin ndaj kabinës ku ishin vendosur sportelet për pagimin e tarifës së Rrugës së Kombit. Ata i janë drejtuar me anë të një letre, Presidentit Meta dhe kryeministrit Rama, ku kërkojnë lirimin e 4 kuksianëve, si dhe ndërprerjen e procedimit penal për personat e tjerë.

"Po s'ju bindët Gjicit, ju heqim pensionin"

Berisha ironizon Ramën: U 'shpartallua' piktori dështak

Pas "përplasjes" së kryeministrit Edi Rama me një ban or të Lezhës gjatë takimit për llogaridhënien e qeverisë, reagoi paraardhësi i tij, Sali Berisha. Përmes një statusi në "Facebook", Berisha shkruan se qytetari ka 'shpartalluar' piktorin gënjeshtar. 'Në Lezhë qytetari shpartallon piktorin dështak dhe rrenc! Ai ia përplas Ramës në fytyrë: 'Shëndetësia është falas vetëm për ty' dhe "për ty fshati nuk ekziston' Përshëndetje të përzemërta lezhjanëve të guximshëm! Sb", shkruan Berisha. Po dje, ish-kryeministri Sali Berisha publikoi në faqen e tij në "Facebook" një tjetër denoncim të qytetarit dixhital. Sipas denoncimit, Safet Gjici ka promovuar një doktor me diplomë false që gjithashtu është kryetar i PS në zonën e Kukësit. Doktori me diplome false, kryetar i PS, promovohet nga Safet Gjici! 'Doktor Krenar Lashi më datën 12.06.2014 shkarkohet nga detyra drejtor shkolle, detyrë të cilën ia dha PS-ja për 35 ditë shkarkohet nga detyra për diplomë false, të cilën e ka marrë i punësuar po në këtë shkollë, pa shkëputje nga puna. Ky person ju sqarojmë se deri më tani mban postin e kryetarit të PS-së me influencë të Safet Gjicit dhe Gëzim Omurit. Këtë person po e promovon Safet Gjici, duke e mbajtur edhe si të fortë. Doktor Krenar Lashi u bën presion të paparë personave invalidë dhe familjeve të tyre se po nuk iu bindët urdhrave të tij dhe të Safetit, do t'ju heqim pensionin e invaliditetit", thuhet në mesazhin dërguar Berishës.

Shkreli: Rruga s'ka standarde, për mirëmbajtjen duhen financime të larta

Peticion Ramës nga tri bashki: Anuloni taksën në Rrugën e Kombit

Kuksianët në burg, këshilltarët letër edhe Metës

Valentina Madani

Rruga e Kombit

Këshilltarët e tri bash kive, Kukës, Has dhe Tropojë i janë drejtuar me një peticion kryeministrit Edi Rama, në të cilin i kërkojnë edhe personalisht të ushtrojë autoritetin ligjor për konsiderimin e kontratës koncesionare në mospërputhje me interesat e komunitetit e si e tillë, të vendosë anulimin e taksës në Rrugën e Kombit për rajonin e Kukësit. Ky është peticioni i dytë i këtyre këshilltarëve lidhur me këtë çështje. Një peticion ata i kanë drejtuar edhe Presidentit të Republikës, Ilir Metës, në të cilin i kërkojnë të ushtrojë autoritetin e tij për lirimin e 4 protestuesve të burgosur. Ata po ashtu kërkojnë ndërprerjen e procedimit penal për personat e tjerë. Ndër të tjera, kryeministrit Edi Rama i kërkojnë që të anulojë tarifën për Rrugën e Kombit, për të cilën kuksianët dolën në protestë. Por, protesta në fjalë degjeneroi në dhunë dhe përplasje mes policisë dhe protestuesve, ku më pas policia vuri në pranga 23 prej tyre. Ishte Gjykata e Kukësit, që liroi 12 prej të arrestuarve, ndërsa disa javë më vonë, Gjykata e Apelit në Shkodër la në burg vetëm 4. Lidhur për tarifën e Rrugës së Kombit, po dje zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës, Artan Shkreli, gjatë takimit me qytetarët e Laçit në kuadër të procesit të llogaridhënies së qeverisë, u shpreh se rrugët në disa akse të vendit janë krejtësisht jashtë standardit. Njëra prej tyre sipas Shkrelit ishte edhe Rruga e Kombit, e cila nuk plotëson standardet dhe për mirëmbajtjen e saj kërkohen financime të larta. "Rruga e Kombit ishte një rrugë fshati me 4 korsi dhe ideja është për kthimin e kësaj rruge me standarde. Për kthimin e kësaj rruge me standarde, kërkohen shuma marramendëse, që nuk i kishim imagjinuar ndonjëherë", tha Shkreli. Konsultimet publike të qeverisë po bëhen paralel me koncesionarin. Para pak ditësh, zv.ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Artan Shkreli, bëri të ditur në takimet me banorët e Hasit dhe të Kukësit se Rruga e Kombit duhet të përfundojë së ndërtuari. "Për të mbaruar kjo rrugë, sipas projekteve fillestare të fizibilitetit, duhen 240 deri 260 milionë euro, pasi asnjë njeri nuk e ka bërë azhornimin se çfarë ka ndodhur gjatë këtyre viteve të fundit kur rruga natyrisht mund të ketë degraduar në elementë të rëndësishëm të saj. 260 milionë euro që nuk janë. Borxhi që lahet çdo vit i kësaj rruge, principal plus interesa është rreth 40% e krejt taksës së qarkullimit, që mblidhet në rang Shqipërie. Rruga është menaxhuar ashtu siç është menaxhuar dhe ka ardhur me një histori të veten, ashtu sikurse ka ardhur. Kjo rrugë duhet mbaruar", nënvizoi Shkreli. Sipas tij, debati që shtrohet aktualisht nuk ka të bëjë me nëse do të ketë apo jo një kalim me pagesë, pasi kjo është e vetmja mënyrë për të shpëtuar këtë aset nga degradimi. Ai sqaroi se është duke u negociuar tanimë me kompaninë një formulë preferenciale për komunitetet lokale. "Ideja këtu nuk shtrohet më që ta bëjmë rrugën me toll apo pa toll. Rruga pa toll do të thotë një rrugë që nuk mirëmbahet dhe gjithë ato miliarda që janë harxhuar do shkojnë drejt degradimit", u shpreh Shkreli.

Padi penale për "Shpërdorim detyre"

Të dhënat personale, PD kallëzon Ramën, Nikollën dhe Manastirliun

Hetimi

"Qëllimi i vetëm është abuzimi me postin dhe funksionin e kryeministrit dhe dy ministreve, si dhe gjithë atij personeli që po detyrohet që ta ushtrojë këtë presion nga lart, vetëm për arsye zgjedhore dhe elektorale".

PD-ja, e përfaqësuar nga deputetët Albana Vokshi dhe Bardh Spahia kallëzuan dje në prokurori, kryeministrin Edi Rama, ministren e Arsimit Lindita Nikolla dhe atë të Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu. Kallëzimi është bërë për shkak të marrjes së të dhënave personale nëpërmjet nxënësve dhe kartelave mjekësore. Partia Demokratike e ka cilësuar si jokushtetuese këtë veprim nga ana e Edi Ramës dhe kabinetit të tij. Vokshi tha se mbledhja e të dhënave personale të pacientëve dhe prindërve të nxënësve, përfshirë NID, bëhet për arsye zgjedhore. "Qëllimi i vetëm është abuzimi me postin dhe funksionin e kryeministrit dhe dy ministreve, si dhe gjithë atij personeli që po detyrohet që ta ushtrojë këtë presion nga lart, vetëm për arsye zgjedhore dhe elektorale. Ndaj edhe në kallëzimin penal ne kemi kërkuar jo vetëm fillimin e hetimeve për shpërdorim detyre dhe përdorim të funksionit politik për arsye elektorale dhe zgjedhore, por kemi kërkuar në të njëjtën kohë edhe pezullimin të të gjithë funksionarëve të kryeministrit dhe të dy ministreve për arsye se ato mund të prishin provat e hetimit", tha deputetja e PD-së.

TAKSAT
MAKINAT

Mjetet e reja dhe të vjetra, caktohet formula sipas vitit të prodhimit

Makinat e përdorura, llogaritja e re e taksës vjetore

Udhëzimi i Ahmetajt, zbardhet tabela me koeficientët

Ornela Manjani

Përcaktohen rregulla të reja për taksën vjetore të mjeteve të përdorura dhe të atyre të cilësuara luksi. Në udhëzimin që mban firmën e ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, përcaktohet koeficienti për çdo automjet, në varësi të viteve të përdorimit. Udhëzimi shoqërohet edhe me shembuj për llogaritjen e taksës vjetore për automjetet. Ai ka hyrë në fuqi ditën e djeshme dhe jep rast konkret se si dhe sa paguhen detyrimet vjetore për makinën. Kështu psh., mjeti me cilindratë 2.993 cm3, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2015 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 22.9.2015, në vlerën 11.972 lekë. Në datën 21.1.2017, pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksën e vitit 2016 në vlerën 13.469 lekë. Duke qenë se është me 4 muaj vonesë për pagesën e taksës vjetore të automjeteve të përdorura, për taksën e mjetit aplikohet 20% gjobë mbi shumën e taksës që duhet të paguajë për vitin 2016, në vlerën 2,694 lekë. Pra, vlera totale që pronari i automjetit duhet të paguajë për vitin 2016 është 16,163 lekë. Nga ana tjetër, duke qenë se është paraqitur më datë 21.1.2017, vlefshmëria e taksës së mësipërme për vitin në vazhdim llogaritet nga data 1.1.2017. Vlefshmëria e TVMP-së për vitin në vazhdim llogaritet nga data 1.1.2017. Për këtë arsye, përveç taksës së vitit 2016, pronari i mjetit detyrohet të paguajë edhe detyrimin e TVMP-së për vitin 2017, në shumën 14,965 lekë dhe vlerën e gjobës prej 5% për një muaj, që është në vlerën 748 lekë. Në total vlera e taksave për vitin 2017 që duhet të paguajë është 15,713 lekë, me afat vlefshmërie deri më 21.1.2018. Të ardhurat nga taksa dhe gjobat për çdo rast mblidhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrue-shëm të mjetit dhe shpërn-dahen sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nga të cilat, 5% strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 25% buxhetit të qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër Buxhetit të Shtetit.

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

TAKSA
DPSHTRR, si agjente e përcaktuar nga ligji për mbledhjen e këtyre taksave, deklaron dhe paguan taksën e mjeteve të përdorura të transportit në administratën tatimore. Vlera e mjetit do të plotësohet nga DPSHTRR në sistemin informatik në fushën "vlera e mjetit", për të gjitha rastet e regjistrimeve të reja, ndryshimit të pronësisë, si dhe kur nga kontrolli është konstatuar se vlera e mjetit nuk është ajo e duhura.

Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze

Në kuptim të ligjit për taksat kombëtare dhe të këtij udhëzimi, "automjet luksoz" konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme: a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm3, ose b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi fillestar në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit.

MAKINAT E IMPORTUARA

Për makinat e importuara dhe që janë të paregjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, vlera e mjetit do të merret nga deklarata me referencë doganore, e cila llogaritet si totali i vlerës së tatueshme (baza e tatueshme) mbi të cilën llogaritet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe duke i shtuar TVSH e llogaritur në doganë (Totali = Baza e tatueshme + TVSH). Kur mjeti blihet nga subjekte të licencuara, vlera e mjetit do të merret nga fatura tatimore e shitjes, e cila është vlera totale e barabartë me vlerën e tatueshme, duke i shtuar edhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Në rast se për të njëjtin mjet disponohen dy ose më shumë dokumente, si për shembull, deklaratë me referencë doganore dhe faturë tatimore shitjeje, gjithmonë do merret për t'u regjistruar në fushën "vlera e mjetit", vlera totale e mjetit që është më e madhe në këto dokumente. Për ato makina që edhe më parë kanë qenë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, kur mjeti blihet nga subjekte të licencuara, vlera e mjetit do të merret nga fatura tatimore e shitjes, e cila është vlera totale e barabartë me vlerën e tatueshme, duke i shtuar edhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

LLOGARITJA SIPAS MJETIT

- **Shembull 1:**

Mjeti me cilindratë 3628 cm3, me naftë dhe vit prodhimi 2008, për vitin 2015 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 27.12.2015, për vlerën 9,524 lekë. Në datën 12.1.2017 pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksën e vitit 2016. Mjetit i ka kaluar afati më shumë se 10 ditë nga afati i vlefshmërisë së taksës, pra llogaritet me 1 muaj vonesë për pagesën e TVMP-së për vitin 2016. Për këtë arsye, pronari i mjetit duhet të paguajë TVMP e vitit 2016 në shumën 9,977 si dhe 5% gjobë mbi shumën e taksës së TVMP-së në shumën 499 lekë. Shuma totale e TVMP-së që duhet të paguajë për vitin 2016 është 16,163 lekë. Gjithashtu, nëse mjeti është me cilindratë më të madhe ose të barabartë me 3000 cm3 detyrohet të paguajë edhe TVML për vitit 2016 në shumën 21,000 lekë dhe gjobë për TVML prej 5% në shumën 1,050 lekë, shuma totale e taksave (TVMP+TVML) që pronari i mjetit duhet të paguajë për vitin 2016 është në shumën 32,526 lekë. Nga ana tjetër, duke qenë se subjekti është paraqitur më datë 12.1.2017, i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së taksave për këtë mjet, detyrohet të paguajë edhe detyrimet për TVMP për vitin 2017, në vlerën 10,431 lekë dhe vlera e gjobës prej 5% për një muaj vonesë, që është në vlerën 522 lekë. Shuma totale që subjekti detyrohet të paguajë është 10,953 lekë. Afati i vlefshmërisë për vitin 2017 fillon nga data 1.1.2017. Gjithashtu, subjekti ka detyrimin të paguajë edhe TVML për vitit 2017 në shumën 21,000 lekë dhe gjobë prej 5% në shumën 1,050 lekë. Shuma totale e taksave për vitin 2017 është në shumën 33,003 lekë me afat vlefshmërie deri në 12.1.2018.

- **Shembull 2:**

Pronari i mjetit me cilindratë 3653 cm3, me benzinë dhe vit prodhimi 2006, paraqitet pranë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të regjistruar për herë të parë mjetin më datë 16.6.2017. Në datën 16.6.2017, pronari i mjetit ka detyrimin të paguajë TVMP-në për 7 muaj të vitit 2017 në shumën 5,966 lekë (3653*0.28*10=10,228/12*7). Duke qenë se është me cilindratë më të madhe ose të barabartë me 3000 cm3, duhet të paguajë dhe TRML në shumën 70,000 lekë dhe TVML për 7 muaj të vitit 2017 në shumën 12,250 (21,000/12*7) lekë. Vlera totale e taksave (TVMP+TVML) që pronari i mjetit duhet të paguajë për vitin 2017 është 88,216 lekë.

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

"Toke Are me sip 865 m2 , me Nr pasurie 131|86 Zona kadastrale nr 1896 , Volumi 9 , faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren **480,000 (katerqind e tetedhjetemije) Lekë .**

Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 11.05.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

" **Truall+Ndertese e rregjistruar ne rregjistrimin hipotekore me nr pasurie 9/268 ne ZK nr 8592, me nr prone 47 , me siperfaqe totale 161 m2 , nga kjo 66 m2 ndertese me adrese I partizani ne Shkoder**
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren **2,240,000 (dymilione e dyqind e katerdhjetemije) Lekë.**
Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date 18.05. 2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

Raporti i Institutit të Statistikave për muajin prill

Uji dhe ushqimet çojnë inflacionin e prillit në 2.1%

Veshje dhe këpucë u rritën me +0,12 pikë përqindje

Rritja e përgjithshme e çmimeve shënoi 2.1% në muajin prill. Ky ishte ritmi më i lartë i rritjes që nga qershori 2017. Sipas të dhënave të INSTAT, ndryshimi u nxit nga rritja e çmimeve të ushqimeve dhe ujit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin prill është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +1,2 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" kanë kontribuar me +0,52 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" kanë kontribuar me +0,12 pikë përqindje. Çmimet e grupeve "Pije alkoolike dhe duhan" dhe "Transporti" kanë kontribuar me +0,06 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve "Argëtim dhe kulturë", "Hotele, kafene dhe restorante" dhe "Mallra dhe shërbime të ndryshme" kanë kontribuar me +0,03 pikë përqindje secili.

Foto ilustruese

SHPORTA

Gjatë prillit, grupi me peshën kryesore në shportën e çmimeve të konsumit, ai i ushqimeve, ruajti një inflacion në nivelin 3.1%, po aq sa në tremujorin e mëparshëm. Si gjithmonë, në muajt e fundit produktet e freskëta bujqësore dhe ushqimore regjistruan nivele të larta të inflacionit, ndërsa çmimet janë në rritje të papërfillshme ose në rënie për shumicën e produkteve ushqimore të përpunuara. Ndërkohë, luhatjet në grupet e tjera ekuilibruan njëra-tjetrën, duke bërë që inflacioni mesatar në ekonomi të jetë i qëndrueshëm. Rritja e çmimeve në grupet "Veshje e këpucë" dhe "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" u balancua nga rënia e inflacionit për grupet "Pije alkoolike dhe duhan", "Transporti" dhe "Komunikimi".

RRITJA MË E MADHE

Krahasuar me muajin prill 2017, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Veshje dhe këpucë" me 3,4%, pasuar nga grupet "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 3,1%, "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 2,5%, "Pije alkoolike dhe duhan" me 1,7%, "Transporti" me 1,0%, "Hotele, kafene dhe restorante" me 0,9%, "Argëtim dhe kulturë" me 0,8%, "Komunikimi" dhe "Shërbimi arsimor" me 0,6% secili.

VLERA E MJETIT

Për vlerën e makinës në kontratën noteriale të shitblerjes dallohen tri raste. Për rastet me kontratë të qirasë financiare (leasing), do të merret vlera totale në kontratën e qirasë financiare dhe jo vlera në kontratën e furnizimit (kontratë shitjeje), e cila i shërben qiramarrësit për njohjen faktike të pronësisë së automjetit nga qiradhënësi te qiramarrësi dhe që lidhet midis palëve vetëm pas shlyerjes prej qiramarrësit të këstit të fundit të qirasë financiare.

Motomjete, autovetura, automjete për transport të përzier		Të gjitha llojet e tjera		Autobusët	
Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09
7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

U dënua nga drejtësia shqiptare si bashkëpunëtor në vrasjen e Azem Hajdarit

Izet Haxhia, ish-truproja i Berishës kthehet në Shqipëri

Turqia ekstradon të dënuarin me 25 vite burg

Izet Haxhia, dje në burgun 313

TIRANE

Izet Haxhia, ish-truproja i Sali Berishës, i akuzuar për vrasjen e Azem Hajdarit u ekstradua mbrëmjen e djeshme nga Turqia. Haxhia u nis nga Stambolli me avion të "Turkish Airlines", ndërsa zbriti në Rinas rreth orës 20:00. Pas mbërritjes në Rinas, Haxhia u dërgua fillimisht në Drejtorinë e Policisë së Tiranës i shoqëruar me autoblind, si dhe nga një grup i gatshëm i burgjeve. Më pas do të transferohet në burgun e sigurisë së lartë 313. Avokati, i cili do të mbrojë ish-truprojën e Sali Berishës mësohet të jetë Fran Dashi. Haxhia u vetëdorëzua tek autoritetet turke disa ditë më parë, ndërsa lajmin e njoftoi përmes faqes në "Facebook". Ai u arrestua në vitin 2006 në Turqi, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga drejtësia shqiptare. Ndërkohë, drejtësia turke nuk ishte shprehur ende për ekstradimin e tij, ndonëse pala shqiptare kishte bërë kërkesa të vazhdueshme në kohën kur në pushtet ishte Sali Berisha. Për 12 vjet me radhë gjykata turke kishte urdhëruar thjesht që ai të mos largohej jashtë vendit, ndërsa në shkurt të këtij viti u mor vendimi që ai të ekstradohet. Izet Haxhia është dënuar nga gjykata shqiptare me 25 vite burg për vrasjen e Azem Hajdarit, akuzë të cilën ai nuk e ka pranuar kurrë. Ekstradimi i tij në Shqipëri mund të çojë në hapjen e dosjes "Hajdari". Sakaq, pritet që Haxhia të përballet me akuzat e drejtësisë shqiptare.

Në muajin prill, ai u vetëdorëzua në policinë turke dhe lajmin e bëri vetë të ditur përmes rrjeteve sociale.

Izet Haxhia është dënuar nga gjykata shqiptare me 25 vjet burg për vrasjen e Azem Hajdarit, akuzë të cilën ai nuk e ka pranuar kurrë, pasi për të, fajtor i vetëm është ish-kryeministri Sali Berisha.

Ai ka deklaruar se vjen në Shqipëri me idenë për rihapjen e dosjes, megjithatë nuk dihet nëse gjykata do ta marrë parasysh kërkesën e tij.

NJOFTIMI I POLICISË

Ekstradohet nga Turqia Izet Haxhiaj, i dënuar me 25 vjet burg për vrasje. Nga specialistët e Interpol Tirana u bë ekstradimi nga Turqia drejt Shqipërisë, i shtetasit shqiptar: Izet Haxhiaj, 52 vjeç, lindur në Babinë, Tropojë. Shtetasi Izet Haxhiaj është shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim penal nr. 316, datë 29.04.2002 e ka dënuar me 25 vjet burg për veprat penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese e kryer në bashkëpunim", "Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim" dhe "Vrasje me paramendim të mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim", parashikuar nga nenet 79/c-25, 78-25 dhe 78-25/22 të Kodit Penal.

Përmbledhje e ngjarjes së ndodhur:

Në datë 12.09.1998, rreth orës 21:15, pranë ish-Selisë Qendrore të Partisë Demokratike në Tiranë janë vrarë me armë zjarri shtetasit A. H., deputet i Kuvendit të Shqipërisë, shtetasi B. Ç. truproja e tij dhe është plagosur rëndë shtetasi tjetër Z. N. Hetimet kanë zbuluar se shtetasi Izet Haxhiaj ka qenë një prej autorëve të kësaj ngjarjeje.

Akuza ndaj Izet Haxhisë

Shtetasi Izet Haxhiaj ësh të shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim penal nr. 316, datë 29.04.2002 e ka dënuar me 25 vjet burg për veprat penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese e kryer në bashkëpunim", "Vra-sje me paramendim e kryer në bashkëpunim" dhe "Vrasje me paramendim të mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim", parashikuar nga nenet 79/c-25, 78-25 dhe 78-25/22 të Kodit Penal.

Avokati i Izet Haxhisë flet për "Studio e Hapur" në "News 24"

"Në kohën e duhur dhe në momentin e duhur do të mësojmë shumë gjëra!"

Në një lidhje telefonike për "Studio e Hapur" të gazetares Eni Vasili në "Neës 24", avokati i Izet Haxhisë, Fran Dashi ka folur për ekstradimin e ish- truprojës së Sali Berishës, i akuzuar për vrasjen e Azem Hajdarit dhe i dënuar me 25 vite burg në mungesë.

Vasili: E keni takuar klientin tuaj?

Dashi: Jo, nuk e kam takuar, shtetasi Haxhiaj është ekstraduar sot nga Turqia dhe është akomoduar në burgun 202 dhe për shkak të lodhjes e kemi lënë për t'u takuar nesër.

Vasili: Veprimi i parë procedural që do bëni ju si avokat?

Dashi: Unë jam një përfaqësues ligjor, nuk jam politik. Komentoj vetëm anën procedurale, nga ana politike nuk e marr përsipër. Do bëjmë më të mirën e mundshme, si pikënisje kemi për të shkuar drejt rihapjes së hetimit, pasi Izet Haxhia është gjykuar edhe dënuar në mungesë. Nuk është pyetur asnjëherë nga trupi gjykues.

Vasili: A është kjo një arsye për t'u rihapur çështja?

Dashi: E parashikon ligji dhe e lejon ligji.

Lala: A keni informacion nëse ministri i Drejtësisë së kohës, z. Rusmajli ka dhënë garanci se do t'i rihapet dosja Izet Haxhisë, nëse do të ekstradohej nga shteti turk drejt Shqipërisë?

Dashi: Dua të jem shumë korrekt. Nuk kam shumë informacion e nuk mund të komentoj një gjë të tillë. Nuk dua të flas para kohe, por në kohën e duhur dhe në momentin e duhur do të mësojmë shumë gjëra.

AVOKATI

> Unë jam një përfaqësues ligjor, nuk jam politik. Komentoj vetëm anën procedurale, nga ana politike nuk e marr përsipër.

REAGIMI

Ekstradimi i Izet Haxhisë, Berisha: Një kriminel tjetër në krah të Edi Ramës

Ish-kryeministri Sali Berisha, i ftuar në "360 Gradë" në "Ora News" komentoi për herë të parë ekstradimin e Izet Haxhisë nga Turqia, ish-truproja e tij, i akuzuar për bashkëpunim në vrasjen e deputetit Azem Hajdari.

Berisha: Një kriminel më shumë në krah të Edi Ramës. Ai është një kriminel i dënuar në Shqipëri me 25 vite burg, i dënuar në Greqi përjetë sipas mediave dhe vjen në krah të Edi Ramës. A i lexove lajmet? Ministria i ka premtuar hapjen e çështjes. Nuk i hap kurrë ministria. I hap drejtësia çështjet. Nxorën fytyrën e tyre. Vjen një kriminel më shumë në krahët e Edi Ramës, siç është Lul Berisha, Emiljano Shullazi. Rama është një frikacak, që ka frikë nga hija e tij. Për 20 vite që i ka ikur drejtësisë shqiptare, ai merr dënim suplementar.

Zheji: Ka një seancë gjyqësore, pse?

Berisha: Ia ka siguruar Edi Rama. Vendimi jo që është automatik, por për 20 vite burg që nuk ka ardhur, ai meriton një ndëshkim të ri, sepse i ka ikur drejtësisë shqiptare për 19 vite me radhë. Konform ligjeve të çdo vendi në botë merr dënim suplementar.

Presidentja e UFSH-së: Kanë përjashtuar kategori pacientësh me diagnoza të ndryshme

Konflikti për listën e barnave me rimbursim, reagime të forta nga farmacistët

Diana Toma: Ja cilat medikamente mungojnë në treg

Voltiza Duro

Fjala në fuqi e listës së re të barnave të rim bursueshme, është shoqëruar me reagime të forta nga rrjeti farmaceutik në Shqipëri, I cili ka hedhur akuza për shkelje ligjore. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", presidentja e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Diana Toma tregon se farmacistët nuk janë njoftuar paraprakisht për futjen e listës së re të barnave në fuqi, çka bie në kundërshti me ligjin, e njëkohësisht sjell humbje të mëdha financiare mbi shërbimin farmaceutik në vend, e madje edhe mbi qytetarin. Gjithashtu, Toma thekson se edhe pse një bar ndodhet në listën e rimbursimit, ai nuk merret më për të gjitha kategoritë e diagnozave, të cilat e merrnin më parë; e shton se kjo situatë do të sjellë konflikte më vonë. Presidentja e UFSH-së bën me dije se tregut farmaceutik i mungojnë disa barna si Dutaseride, warfarin lercadipine 20 mg, lorazepam, trimetazidin, acid ibandronic, ibersartan, salbutamol inhaler, letrauol 2,4 mg etj.

Presidentja e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Diana Tomat

Në datën 5 maj ka hyrë në fuqi lista e re e barnave të rimbursueshme për 2018. Si u lajmëruan farmacistët në lidhje me këtë ndryshim?

Nga informacioni që na kanë përcjellë farmacistët, kemi mësuar se nuk pati asnjë njoftim zyrtar, qoftë shkresor qoftë verbal. Farmacistët e kuptuan se kishte hyrë në përdorim lista e re e barnave në momentin kur kanë provuar të ekzekutojnë një recetë të rimbursueshme dhe në program janë shfaqur të dhëna që nuk i takonin listës së mëparshme, por asaj të re. Në mesditën e datës 5 maj (ditë e shtunë) janë marrë në telefon nga punonjës të DRSKSH-ve ku u është bërë me dije se duhet të paraqiteshin pranë këtyre institucioneve për të marrë udhëzimin për lidhjen e kontratës dhe se kontrata ndodhej në faqen zyrtare të Fondit.

Pse erdhi një reagim i fortë nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në lidhje me këtë?

UFSH është institucion që përfaqëson në mënyrë institucionale farmacistët, gjithashtu, po në mënyrë ligjore ka për detyrë t'i mbrojë ata nga veprimet arbitrare të administratës publike apo private qoftë ajo. Ndaj, në këtë kuadër, reagimi i UFSH-së ka qenë thjesht plotësim i një detyre dhe kërkim i një të drejte.

Ju keni ngritur si shqetësim faktin që po shkaktohen humbje të mëdha financiare në rrjetin farmaceutik. A mund ti shpjegoni në mënyrë më të detajuar?

Para se të ngremë shqetësimin e humbjeve financiare ngremë shqetësimin e shkeljeve të ligjit dhe tregojmë pasojat që sjell kjo shkelje. Humbja financiare është një ndër pasojat rrjedhojë e një sërë shkeljesh ligjore të cilat, rëndojnë mbi farmacistët dhe subjektet farmaceutike, mbi shërbimin farmaceutik dhe për pasojë dhe mbi qytetarin. Është e pa pranueshme që këto shkelje ligjore bëhen nga një institucion shtetëror, i cili duhej të jepte shembullin e zbatimit me përpikmëri të ligjit.

A përjashtohen nga lista e re e rimbursimit kategori të ndryshme individësh dhe nëse po, a kanë pasur konflikte farmacistët me pacientët?

Nga informacioni që kemi prej kolegëve tanë, ndonëse një bar ndodhet në listën e rimbursimit, ai nuk merret më për të gjitha kategoritë e diagnozave të cilat e merrnin më parë, dhe nëse nuk kemi pasur raportime për konflikte të deri tanishme, pasi në përgjithësi recetat me rimbursim kanë një aplikim dy mujor, konflikte do ketë në momentin që këta pacientë, të cilët deri dje e kanë marrë një bar të caktuar me rimbursim, për diagnozën që kanë, do jenë të përjashtuar nga mundësia e rimarrjes. Kjo gjë, do ndikojë negativisht veç asaj çfarë shpjeguam më sipër dhe në marrëdhënien e drejtpërdrejtë farmacist - pacient, e cila nga efekte të tilla ka pasur pasoja negative dhe herë të tjera.

A është konstatuar mungesë medikamentesh, cilat prej tyre mungojnë?

Po prapë nga kolegët që operojnë në rrjetin e hapur, kemi informacion se mungojnë një sërë medikamentesh, ku në to përfshihen dhe alternative të vetme. Si profesioniste në fushën e shëndetësisë para numrit të mungesave do vlerësoja faktin e mungesës si fenomen. Duhet ta kemi të qartë që e drejta për shëndet është një e drejtë, e cila buron nga akti themeltar i shteti të së drejtës, që është Kushtetuta. Për ta ruajtur këtë shëndet apo për ta çuar qytetarin në një jetë të shëndetshme e domosdoshme veç diagnostikimeve mjekësore është dhe marrja e mjekimit. Jo të pakta janë rastet kur një numër pacientësh ka nevojë vetëm për një lloj bari, ndaj unë mendoj që çdo mungesë në tregun farmaceutik ka një kosto mbi shëndetin, ndaj duhet marrë në konsideratë. Për të qenë korrekt deri në fund me pyetjen tuaj mund të përmend disa emra barnash të cilat kanë mungesa në treg: Dutaseride, warfarin lercadipine 20 mg, lorazepam, trimetazidin, acid ibandronic, ibersartan, salbutamol inhaler, letrauol 2,4 mg etj.

Ju e keni vlerësuar kontratën Farmaci-Fond si të njëanshme. Pse vjen një vlerësim i tillë?

Mënyra e hartimit si dhe përmbajtja e saj flasin për njëanshmëri të plotë. Aq e madhe është kjo një anshmëri sa veç kontratë dypalëshe nuk mund të quhet, pasi në konceptin e hartimit të kontratës, palët njohin të drejtat dhe detyrimet respektive dhe nuk ka kontrata të cilat njërës palë i japin të drejtë të ketë veç të drejta dhe palës tjetër veç detyrime. Kur e lexon kontratën të duket sikur ke dy grupime shoqërore atë të skllevërve që kanë veç detyrë të binden e të skllavopronarit që ka veç detyrë të diktojë e të përfitojë. Meqenëse kjo kontratë është produkt i Fondit, duhen pyetur hartuesit e saj lidhur me qëllimet reale pse kjo kontratë është hartuar në këtë formë si dhe duhen pyetur se ku e gjejnë guximin dhe mbështetjen të shkelin hapur, pa përmasa dhe pa frikë ligjet e këtij vendi.

A i mbahen lekë pacientit për recetën elektronike?

Po, pacientit i mbahen lekë për recetën elektronike ndonëse të tëra kostot e kësaj recete në mënyrë të padrejtë i janë faturuar farmacisë. Vlera që i mbahet pacientit është 100 lekë dhe në qoftë se farmacia nuk ia mban këto lekë pacientit Fondi ia mban farmacisë.

Si mendoni se mund t'i jepet zgjidhje problemeve të sipërpërmendura?

Problemet të cilat lindin thjesht dhe vetëm nga shkelja e ligjit zgjidhen duke kërkuar zbatimin e ligjit dhe duke vënë para përgjegjësisë shkelësit e ligjit.

KONTRATA

"Kur e lexon kontratën të duket sikur ke dy grupime shoqërore, atë të skllevërve që kanë veç detyrë të binden e të skllavopronarit që ka veç detyrë të diktojë e të përfitojë. Meqenëse kjo kontratë është produkt i Fondit, duhen pyetur hartuesit e saj lidhur me qëllimet reale pse kjo kontratë është hartuar në këtë formë si dhe duhen pyetur se ku e gjejnë guximin dhe mbështetjen të shkelin hapur, pa përmasa dhe pa frikë ligjet e këtij vendi".

"36 barna të reja, ja cilat diagnoza do mbulojnë"

Ahmeti: Ulen çmimet e barnave, përfitojnë 475 mijë qytetarë

Lista e re e barnave me rimbursim përmban 1175 alternativa tregtare, 568 barna alternative të para dhe 244 principe aktive, nga e cila do të përfitojnë 475 mijë qytetarë në mbarë vendi. Kjo është deklarata e bërë ditën e djeshme nga, drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Eduard Ahmeti, i cili ka theksuar se janë përshirë në listë 36 barna të rinj për diagnoza të ndryshme. "Në listën e vitit 2018 janë përfshirë 36 barna të rinj për diagnoza si insuficiencë kardiake, kancer, hepatit C, demence/alzheimer, diabet, etj. Padyshim risi është përfshirja në këtë listë e herceptines", tha Ahmeti. Më tej ky i fundit shtoi se çmimi i barnave të LBR-së është ulur me 11%, krahasuar me listën e një viti më parë dhe theksoi faktin që nga barnat e reja do të përfitojnë rreth 10 mijë qytetarë.

Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Eduard Ahmeti

LISTA

"Në listën e vitit 2018 janë përfshirë 36 barna të reja për diagnoza si insuficiencë kardiake, kancer, hepatit C, demence/ alzheimer, diabet, etj. Padyshim risi është përfshirja në këtë listë e herceptines", tha Ahmeti

SHKELJET

"Humbja financiare është një ndër pasojat rrjedhojë e një sërë shkeljesh ligjore, të cilat rëndojnë mbi farmacistët dhe subjektet farmaceutike, mbi shërbimin farmaceutik dhe për pasojë edhe mbi qytetarin".

BIOGRAFIA

ISH-DIKTATORI/ PJESA II

Një këndvështrim ndryshe i Josip Broz Tito, antishqiptarit të sofistikuar

"Hoxha pyeti me gjysmë zëri Titon se ç'do të bëhet me Kosovën"

Shqiptarët s'i besonin propagandës së Titos mbi gjoja të quajturin Bratstvo-Jedinstvo

Nga Spartak Topollaj *

Edhe pse kanë kaluar gati 40 vjet nga jeta e tij, është e çuditshme, madje e papranueshme, që ende sot e kësaj dite shumë shqiptarë, këtej dhe andej kufirit, apo në diasporë, të kenë iluzione për Titon, këtë antishqiptar të përbetuar, konsekuent dhe të sofistikuar, i cili djallëzisht, herë haptazi dhe herë fshehurazi, së bashku me anturazhin e ngushtë të tij, e luajti kartën shqiptare në lojën dhe luftën politike mes qarqeve sunduese nacionaliste dhe shovene të Federatës Jugosllave (ku shquanin ato serbe), vetëm në favor të pushtetit jetëgjatë e absolut personal të tij. Dhe është pikërisht për këtë, qëllimi i këtij shkrimi, i cili synon të sqarojë disa të vërteta të mëdha, që pluhuri i kohës, apo dhe më keq akoma, ato të arkivave, t'i kenë fshehur dhe zhdukur sa mundën. Dhe e gjitha kjo, jo edhe pa ndihmën e duarve të gjata e të zeza që lëvizin tinëz në bodrumet e errëta të tyre, sa në Beograd, aq dhe në Moskë…?!

(vijon nga numri i kaluar)

TITO DHE E VËRTETA E MADHE E ANTISHQIPTARIZMIT TË DJALLËZUAR TË TIJ

Trojet dhe kombi shqiptar kanë historinë e tyre të lashtë e të shquar, që jo çdo vend e çdo komb e ka. Kur të parët tanë Ilirët dhe ne pasardhësit e tyre, prej mijëra vitesh ishim dhe jemi në këto troje me gjuhën, kulturën, traditat e historinë tonë, sllavët erdhën nga humbëtirat e stepave të Azisë mes shekujve VI-VII të Erës Sonë, Ekspansioni ose më sakte invazioni sllav u përhap me shpejtësi dhe forcë, veçanërisht nga gjysma e dytë e shekullit te XI, kur edhe pas Shizmës së madhe të Kishës Romane, Ortodoksia në Lindje u përqafua prej tyre. Në shekujt që pasuan ishte Kisha, pushteti i invazorëve sllavë e më vonë edhe "akademikët" e tyre, që s'reshtën në përpjekjet e tyre për shkombëtarizimin e autoktonëve arbëresho - shqiptar. Këto synime kulmuan në 1844 me Naçertanien e Ilia Garashaninit, (Ministër i Brendshëm e Kryeministër 1861 - 1867) që ishte Doktrina e Shenjtë Serbe për Luftë Speciale

dhe synonte ringritjen e Serbisë së shekullit të XIV të Krajl Stefan Dushanit! Naçertania shërbeu si platformë kryesisht antishqiptare, madje deri në ditët tona me Çubrilloviçët, Andriçët, Rankoviçët, Qosiçët e Millosheviçët, pa harruar vetë Titon, inspirues tinzar e i nëndheshëm për shumë prej tyre! Madje, ai dhe shpura e tij politiko-shkencore e "akademikëve" të Beogradit, bënin sikur nuk e dinin historinë, teksa "harronin" Lidhjen Shqiptare të Prizrenit që shpallte AUTONOMINE e të gjitha trojeve tona, (1878) apo Kryengritjet e mëdha të Veriut në preludin e PAVARESISE(1912).

Duke u rikthyer te periudha e Luftës së Dytë Botërore, nuk mund të injorohet fakti se shqiptarët i pritën me pushkë pushtuesit fashistë italianë, që me 7 Prill 1939, duke bërë rezistencë në mënyra të ndryshme, pra dy vjet e gjysmë përpara se komunistet e Grupeve në pranimë dhe diktatin e të deleguarve të Titos të shpallnin krijimin e PKSH-së më 8 Nëntor 1941, pa zgjedhur askënd në krye të saj. Nga ana tjetër, edhe intelektualë të shkolluar në Perëndim, nga familjet e shquara atdhetare ,antifashiste, nacionaliste, legaliste apo balliste kishin filluar të organizohen në forma të ndryshme nga Çamëria në Kosovë, madje ishte përparësia për Çështjen Kombëtare dhe Lirinë e Atdheut, që bëri bashkë nacionalistë e komunistë në Pezë e Mukje. E pikërisht këtu, "shokët" jugosllavë, natyrisht me dijeninë e miratimin e Titos, nxorën thonjtë dhe dhëmbët, duke e quajtur tradhti të komunistëve kompromisin për luftë të përbashkët me nacionalistët, që natyrshëm kërkonin me plot të drejtë, rikthimin e të gjitha trojeve tona etnike pas Luftës. Pasi shantazhuan vasalin e tyre Enver Hoxha, e detyruan atë të hedhë poshtë Marrëveshjen dhe të dënojë të deleguarit e saj në Mukje, Ymer Dishnica e Mustafa Gjinishi, duke burgosur e internuar për dekada te tëra këtë mjek të shquar, pra Dr. Dishnicën dhe eliminuar fizikisht me pabesi, pas shpine, M.Gjinishin që gjatë Luftës. E gjithë dërgata e Titos, gjatë gjithë kësaj kohe e nënshtroi, madje e poshtëroi udhëheqjen e PKSH-së dhe vetë Hoxhën, duke imponuar vijën antishqiptare të Titos dhe atë të PKJ-së. Me nxitjen e jugosllavëve pothuaj të gjithë nacionalistët, personalitete të familjeve të shquara për atdhetari e kulturë, u përjashtuan nga KANÇ. Një krim i tmerrshëm dhe i pafalshëm qe Masakra e Tivarit ndaj mijëra të rinjve kosovarë, për të cilën Hoxha dhe Ramiz Alia duhet të damkosen përjetësisht si tradhtarë, të pabesë e vëllavrasës. Marrëveshjet sklavëruese në ekonomi, financa, Ushtri e Sigurim ku bënin ligjin kështilltarët jugosllavë, po përgatisnin terrenin për shndërrimin e Shqipërisë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Kulmi i poshtërimit ishte vizita gati dy javore e Hoxhës në Beograd, gjatë së cilës, ndërsa i jepnin atij paradoksalisht dekoratën më të lartë të heroit të popujve të Jugosllavisë, refuzuan kategorikisht ta lejonin të vizitonte Kosovën, qoftë edhe formalisht për disa orë, e për më keq akoma, edhe kur ai me gjysmë zëri pyeti Titon se ç`do të bëhet me Kosovën, mori përgjigjen djallëzore të tij, se ishte absolutisht e pamundur nga që këtë nuk kish si ta kuptonin serbët?! Sipas kësaj logjike, Tito e kishte të vështirë t'i bindte serbët të jepnin atë, që pa qenë e tyre e kishin marrë padrejtësisht, djallëzisht dhe me dhunë, ndërsa "patrioti i madh", Enveri ynë, e paskësh pasur të lehtë mirëkuptimin e shqiptarëve, për gënjeshtrën gati pesë vjeçare gjatë Luftës Antifashiste, se Çështjen e trojeve shqiptare do ta zgjidhim me "vëllezërit" jugosllavë, kur lufta të mbarojë! Në nëntor të 1947 Hoxha dhe politbyroja injorante e PKSH-së, me shumë jo shqiptarë në përbërje, duke u përulur me trup e me turp ndaj jugosllavëve, vetëvranë si antijugosllav Nako Spirun, duke mos lejuar të fejuarën e tij, Liri Belishova, anëtare edhe kjo e udhëheqjes së lartë, ta shihte për herë të fundit në spital gjatë orëve të agonisë! Tito ndërkohë kulmon me poshtërsinë dhe antishqiptarizmin e tij, teksa propozon e insiston të futen në Korçë dy divizione të Armatës Jugosllave, nën pretekstin përsëri djallëzor, që të na mbronte nga një rrezik grek!

Stalini dhe Kominterni që mbahej e hazdisej në luksin e hoteleve të Moskës e daçave të periferisë apo vendet klimatike të pushimit prej tij, e i bënte fresk këtij fshatari brutal gjeorgjian, përgjegjës për 27 milionë të vrarët e të zhdukurit në BRSS, (rekord absolut i zi për GINES) nuk mund të lejonin kultin e një tjetër diktatori, që çdo ditë e më shumë po kopjonte e imitonte vetë Stalinin, e që madje guxonte edhe ta stigmatizonte atë. Ndaj pas Letrave të Informbyrosë, që Tito i injoroi e hodhi poshtë publikisht, erdhi deri te shizma e parë e madhe e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare e pas L. II B. Pikërisht nga kjo, u trimërua dhe përfitoi Enver Hoxha, që u prish përkohësisht me jugosllavët, bash në prag

Josip Broz Tito

të Kongresit të Parë të PKSH-së, duke dënuar bandën trockisto-titiste të Koçi Xoxes & Co. siç edhe e etiketoi atë. Xoxe deri më atë kohë Nr. 2 i Partisë dhe i Shtetit, pa dashje i dha emrin e tij kësaj kohe të një represioni terrorist të egër e të paparë shtetëror, Po ky ishte dhe është një gabim i rëndë që bëhet, kuptohet se djallëzisht pas tij fshihej çifti makbethian Hoxha, sepse ishte vetë Xoxe, që në finale të gjyqit, publikisht deklaroi se: Çdo gjë e çdo krim që kam bërë, ka ndodhur me dijeninë dhe miratimin e Komandantit, ndaj do të jem bir k..ve, po fola qoftë dhe një fjalë të vetme. Dhe dihet, se menjëherë pas kësaj e vunë para plotonit të ekzekutimit, duke ia mbyllur gojën njëherë e përgjithmonë! Ende atij, edhe sot e kësaj dite, s'i është gjetur varri, por gati 70 vite pas ekzekutimit, dëshmi e dokumente të shumta që vërtetojnë krimet e torturat e përbindshme të asaj kohe, të cilat nuk mund të varrosen kurrë, që me plot gojën duhet quajtur, koha e diktatorit më të egër stalinist në Europën e pas Luftës së Dytë Botërore.

Prej një kohe të gjatë, shqiptarët nën Serbi apo Jugosllavi u përballën me krime, gjenocid, masakra, përdhunime, tortura, burgosje, internime dhe deportime prej pushteteve të radhës, ndaj ata e kishin të vështirë të bindeshin në sinqeritetin e më pak akoma t'i besonin propagandës së komunistëve të Titos gjatë L. II B. mbi gjoja të quajturin Bratstvo-Jedinstvo (Vl-

➔

lazërim - Bashkim).Nga ana tjetër, pushteti i ri italian dhe gjerman i sapovendosur, shpalli bashkimin e trojeve shqiptare, nën një administratë të vetme shqiptare dhe nxiti hapjen e shkollave shqipe. Për të dyja këto arsye, në trojet shqiptare në Jugosllavi nuk u mbrrit deri te formimi i njësive të mëdha partizane, apo të një lëvizje të mirëorganizuar komuniste. Përkundrazi, forcat nacionaliste, të Shaban Polluzhës, Bedri Pejanit, Dem Ali Pozharit e të tjerëve, për arsyet e sqaruara më sipër gjetën terren më të favorshëm e përkrahje më të madhe.

Besojmë të jetë kuptimplote e domethënëse lista relativisht e gjatë e udhëheqjes së PKJ-së, Ushtrisë e shtetit jugosllav me Titon në krye, për të kuptuar dhe vërtetuar se për Marshallin, shqiptarët ishin dhe mbetën në margjina e përherë të nënvlerësuar, si qytetarë të dorës së dytë nën diskriminim. Kështu, edhe pse hierarkia e udhëheqjes ndryshonte sipas dëshirave e koniukturave të Titos, e pasuesve të tij, le të njihemi me më kryesorët: Ivo Lola Ribar, Mosha Pijade, Boris Kidriç, Eduard Kardel, Aleksander Rankoviç, Koça Popoviç, Arso Jovanoviç, Millovan Gjillas, Petar Stamboliç, S. V. Tempo, Bllazho Jovanoviç, Peko Dapceviç, Ivan Goshnjak, Streten Zhujoviç, Kosta Nagj, Jovo Kapiçiç, Milladin Popoviç, Dushan Mugosha, Stane Dollanc, Vladimir Bakariç, Ivan Millutinoviç, Nikolla Ljubiçiç, Branko Mamulla, Llazar Kolishevski, Kiro Gligorov, Xhemal Bijediç, Veselin Gjuranoviç, Mika Shpiljak, Marko Nikeziç, Latinka Peroviç, Millka Pllaninç, Savka Dapceviç Kucar, Mirko Tepovaç, Cvijetin Mijatoviç, Kërste Cervenkovski, Ante Markoviç, Budimir Lonçar, Millan Paniç, Stipe Mesiç, Borisav Joviç, Ivan Stamboliç, Franjo Tugjman, Raif Dizdareviç, Alija Izetbegoviç, Hamdija Pozderaç, Momir Bullatoviç, Millo Gjukanoviç, Ll. Moisov, V. Tupurkovski, S. Potoçar, S. Korosheç, Milan Kuçan , J. Dernovshek, Dobrica Qosiç, Sllobodan Millosheviç, V. Sheshel, R, Karaxhiç, R. Mlladiç, V. Koshtunica, Z. Xhinxhiç, Millan Millutinoviç, Nikoliç, Daçiç, Vuçiç etj etj

Në të gjallë të Titos, vetëm dy shqiptarë ishin për një farë kohe në udhëheqje, njëri në nivel Federate, Fadil Hoxha, personalitet shpesh kontravers dhe tepër i diskutueshëm dhe tjetri në kryesinë e LKJ-së, Mahmud Bakalli që reflektoi dhe u shfaq autokritik pas viteve' 90 nga udhëheqsia shqiptare e Kosovës, më të njohurit ishin: Sinan Hasani, Xhavid dhe Elhami Nimani, Kolë Shiroka, Veli Deva, Iljaz Kurteshi, Ali Shukriu, Rrahman Morina, Mehmet Maliqi, Ymer Pula, Azem Vllasi, Kaqusha Jashari etj. Lidhur me rolin, vlerat, gabimet, fajet dhe përgjegjësitë e secilit, patjetër e kemi një opinion, por qëllimi i këtij shkrimi, që në krye të herës kuptohet se nuk është ky. Megjithatë, për ata ka një klasifikim, të cilit nuk mund t'i shpëtojë dot asnjëri prej tyre, të parët, janë ata që s'e pranuan kurrë dhe nuk bënë kompromis me regjimin titist e pas titist, duke vuajtur të gjitha pasojat deri në burgosje, tortura dhe eliminime fizike, të dytët u konformuan dhe bashkëjetuan me pushtetin, edhe pse nuk e donin, madje dhe e urrenin atë, por deri këtu guxuan, dhe të tretët, që u nënshtruan, e më keq akoma, u vunë në shërbim të pushtetit titist apo atij serbomadh millosheviçian kundër bashkëkombësve të tyre, pra vëllezërve të një gjaku e një gjuhe.

Me mbarimin e Luftës Antifashiste, shqiptarët në trojet e tyre në Jugosllavi, përsëri mbetën në robëri dhe për më keq akoma, nën pretekstin se ata nuk iu ishin bashkuar masivisht komunistëve që udhëhiqnin njësitë partizane të Titos dhe s'e pranuan lehtë regjimin e ri, pësuan represionin më të egër të OZNA-s, UDB-as dhe JNA-së, që kulmuan me "Aksionin e armëve". Edhe pse për krimet e egra ndaj shqiptarëve, si rëndom ndodh me regjimet totalitare, janë zhdukur mjaft prova dhe dokumente, janë gjallë edhe sot shumë syresh, apo dhe të afërmit e mbi 50.000 të ekzekutuarve, të torturuarve e burgosurve nga klika Tito-Rankovic gjatë 20 viteve 194 - 1966 në Goli Otok, Nish, Idrizovë, Mitrovicë etj., që së bashku, dëshmojnë me prova të pakundërshtueshme se pas këtij viti (1966)" Mjeshtri i Madh" Tito i lau duart si Pons Pilati në Plenumin e Brioneve, duke ia veshur fajet dhe përgjegjësitë Rankoviçit, i cili, në fakt, duhet thënë se deri sa vdiq më 1983, nuk pësoi asgjë!!! Po me djallëz-

inë e Titos, shqiptarët u ndanë në tri republika, Serbi, Maqedoni dhe Mal i Zi. Kosovës iu dha statusi i Krahinës (Obllast) brenda Serbisë dhe Rrafshin e Dukagjinit e quanin Metohi, ndërsa, nga ana tjetër, qysh më 1953 asaj ia morën edhe një territor jo të vogël (Lugina e Preshevës), për t'ia dhënë Serbisë!!! Djallëzisht dhe pa bujë, në marrëveshje me qeveritë hilegare të Turqisë dhe liderëve të saj, Inony, Bajar, Menderes dhe Gyrsel, Tito realizoi deportimin kriminal të 500.000 shqiptarëve nga trojet e mrekullueshme amtare, drejt Anadollit të thatë e të shkretë!!! Pranvera e trazuar e 1968 në Europë ngriti në revolta edhe intelektualët mendjehapur e rininë studentore shqiptare në Jugosllavi. Ata kërkonin liri e të drejta si popujt e tjerë të Federatës: Republikë, Flamur, Universitet etj. Ky vit shënonte edhe 500- vjetorin e vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, që mbetej frymëzim i përjetshëm për të gjithë

shqiptarët kudo në Botë. Ndërkohë, edhe pse pak a shumë gandist, predikues i pajtimit, shkrimtari Adem Demaçi, ishte dënuar me afat të gjatë burgimi, për librin "Gjarpijt e Gjakut". Ky qe Tito "liberali", që nuk vonoi të përdorë represionin ushtarako-policor dhe dhunën e egër shtetërore ndaj qytetarëve shqiptarë, të konsideruar si të kategorisë së dytë, (edhe pse Rankoviçi kish filluar vakancat e gjata), dhunë nga e cila bëri një tërheqje taktikodemagogjike në vitin që pasoi, pra 1969, kur nga frika njohu të drejtën e flamurit, simboleve kombëtare, universitetin, Institutin Albanologjik, dygjuhësinë dhe u hapën shkolla, teatro, Radiotelevizioni i Prishtinës gazeta e revista shqip. Kosovës iu dha statusi i Krahinës Socialiste Autonome, por jo ai i Republikës! Ky status, pra Republika, iu njoh Malit të Zi nga Tito, edhe pse me pesë here më pak popullsi se Kosova, apo Maqedonisë, që kishte gati të njëjtën popullsi me të! I detyruar nga presioni në rritje i shqiptarëve dhe për të ruajtur ekuilibrat në federatën amalgamë e plot nacionalizma shpërthyese, Tito shpalli Kushtetutën e Re, atë të"74, ku Kosova njihej si krahinë autonome, pjesë konstituive e saj me të drejtë vetëvendosje, deri në SHKEPUTJE, si gjashtë Republikat dhe Vojvodina, Krahina tjetër autonome është e kuptueshme që Tito të mendonte "pak" edhe për vete, teksa shpallej President i Përjetshëm i Jugosllavisë edhe "de jure". Vetëm pak muaj pas vdekjes së Titos, në pranverën e 81-shit, shqiptarët u ngritën në protesta dhe demonstrata të fuqishme për të drejtat e tyre, gjatë të cilave u vranë 23 vetë. Tirana zyrtare heshti për turpin e saj dhe vetëm kur agjencitë e lajmeve dhe TV e huaja, publikuan pamje të shtypjes së përgjakshme të protestave, filluan lajmet për atë që ndodhte në gjysmën tjetër të kombit. Më vonë, saktësisht më 1989 Millosheviçi, me rastin e 600-vjetorit të betejës së Fushë -Kosovës (në festën e humbjes, pra) e hodhi poshtë Kushtetutën dhe rivendosi regjimin diktatorial serb, duke shtypur me zjarr e hekur të drejtat e liritë e shqiptarëve, të siguruara mes sakrificash të panumërta.

Pikërisht në këtë kohë një grup intelektualësh, kryesisht profesorësh universitarë e studentësh, themeluan në dhjetor të 1989 në Prishtinë LDK, në krye të së cilës zgjodhën dr.Rugovën, këtë personalitet gati unikal, Gandin e Ballkanit, Presidentin e ardhshëm të Republikës së Kosovës.

Çuditërisht, edhe sot pas gjithë këtyre, disa mendje pafille, vazhdojnë të mendojnë se "i përjetshmi President Tito", paskej qenë proshqiptar! Po pse Kosova me një popullsi të re, me pasuri aq të shumta mbi e nëntokësore, me klimë e tokë të mrekullueshme, me lumenj e liqene mbetej pjesa më e pazhvilluar e Jugosllavisë? Apo edhe këtë s'e paska ditur Tito?! Të vetmen gjë që lejoi, madje dhe e nxiste kudo ku kishte shqiptarë, ishte ndërtimi i xhamive. Ata që mendojnë se kjo s'qe një gjë e keqe, se i ruajti shqiptarët nga asimilimi, në rastin më të mirë janë naivë. Kjo qe një bombë me plasje të vonuar, e qitje të largët, e para ua kthente nderin turqve që pranonin të shpërngulurit, e dyta u bënte qejfin myslimanëve të llojit Naser, Sukarno, Burgiba, Gadafi etj, që i kishte me shumicë te të paangazhuarit, ku ishte violinë e parë dhe në fund, i paraqiste shqiptarët para Perëndimit të krishterë, si të prapambetur, madje që edhe nuk e duan zhvillimin, e që nesër mund të kthehen në ekstremistë islamikë!

RETROSPEKTIVË...

Pas vdekjes së Stalinit dhe ekzekutimit të Berias, trojka Hrushov-Malenkov-Bulganin, para, gjatë, e pas Kongresit të XX,(23 Shkurt 1956) në kuadër të destalinizimit, përgatitën rehabilitimin e të persekutuarve prej tij, ku një vend "nderi" i takonte edhe Titos, paçka se edhe vetë ky, në periudha të ndryshme, kish imituar Stalinin, për të mos thënë që edhe ia kish kaluar në disa raste atij. Presion të drejtpërdrejtë iu bë PPSH-së dhe personalisht Stalinit tonë të vogël, Enver Hoxha, i cili e kish të vështirë të bindej për kushtin jugosllav për pajtim, rehabilitimin e Xoxes. Këtë e tregoi Konferenca e Tiranës, e pranverës '56, e cila sa nuk çoi ne përmbysjen e Hoxhës që pushonte i qetë në Vlorë, por që pasi u njoftua, erdhi me urgjencë në Tiranë, mori situatën nën kontroll dhe urdhëroi Sigurimin për arrestimin e dhjetëra kritikëve, kryesorët e të cilëve i akuzoi si agjentë të Beogradit! Kështu u pushkatuan Liri Gega, anëtare e politbyrosë edhe pse 8 muajsh shtatzënë, Komandanti i Korparmatës së Parë, bashkëshorti i saj Gjeneral Dali Ndreu i legjendës së kryengritjeve antiserbë, Elez Isuf Ndreu, kolonel Petro Bullati, gruaja e të cilit ishte motra e Vasil Shantos, ndërsa shumë e shumë të tjerë, përfshi dy nga figurat kryesore të Partisë, Luftës, dhe Pushtetit komunist, Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu, morën ndëshkime të rënda me burg politik, e ndërsa i pari nuk doli gjallë, pasi u la të vdiste në spitalin e burgut, i dyti ia doli të jetojë disa vite në demokraci, i liruar prej saj nga burgu dhe mbetet ndër të paktët (si e ndjera Liri Belishova dhe Gjeneral Leitnant Rahman Parllaku) që pranoi krimet e përgjegjësitë, madje edhe kërkoi falje publikisht. Me 16 maj '57 u arratis ne Jugosllavi Panajot Plaku, anëtar i KQ, ministër, deputet, gjeneral, i vdekur më 1969 në Beograd në rrethana misterioze (me shume gjasë eliminuar nga agjentura e Sigurimit), të cilit, para e pas tij iu eliminuan të gjithë vëllezërit. Në maj të'61 u zhvillua farsa gjyqësore për grupin poliagjenturor të Teme Sejkos?! Si Temja, ashtu dhe vëllezërit e djali i tij, gjithashtu, u ekzekutuan, ndërsa e shoqja bëri vetëvrasje dhe djali tjetër u dënua me 10 vjet burg. Më pas, radhën e pati Liri Belishova, anëtare e BP dhe Sekretare e KQ; burri i saj i dytë Maqo Çomo, edhe ky ministër i Bujqësisë e anëtar i KQ si dhe Koço Tashko një ndër themeluesit e Partisë, e Kryetar i Komisionit të Kontroll Revizionimit të saj. Pas një farë " qetësie " relative , në dekadën '73 -' 83 , diktatori dhe Elena Çaushesku shqiptare , N. Hoxha, të ndihmuar nga i përzgjedhuri i tyre si diktatori i fundit shqiptar, Ramiz Alia, shpartalluan grupet "armiqësore" në ideologji, ekonomi e ushtri, dhe atë të M.Shehut e K. Hazbiu, duke ekzekutuar gati gjysmën e Byrosë Politike!

Por cili ishte raporti i vërtetë mes miq-armiqve Enver-Tito? A ishin të sinqerta anatemimet dhe akuzat e ndërsjella mes tyre? Pse Hoxha nuk e përmendi kurrë dëshminë e Gjillasit, që në gjallje të tyre, se në takimin me Stalinin në Kremlin, ky i fundit, teksa po diskutonin për Shqipërinë, bëri gjestin kuptimplotë të GËLLTITJES, pra me qartë s'kish ku të shkonte: GËLLTITENI SHQIPËRINË! Si mund të kuptohet ndryshe, veçse si një tradhti kombëtare e Enverit, Marrëveshja për Shkëmbimin e të Arratisurve me Titon, kur në të gjitha rastet ata ishin pa përjashtim shqiptarë dhe dihej fataliteti i tyre këtej e andej kufirit! Si shpjegohet që me gjithë anatemimin mes tyre, Jugosllavia e Titos mbetej partnerja e parë në shkëmbimet ekonomiko - tregtare e Shqipërisë Socialiste, vlera e të cilave në apogjeun e vet mbërriti deri në 112 milionë $ amerikanë të kohës dhe a llogariste Enveri një aleancë shqiptaro-jugosllavo- rumune, në rast të një agresioni sovjetik! Pse ai, pamfletin "Titistët" e publikoi vetëm pas vdekjes së Titos? A ka ekzistuar edhe një tjetër marrëveshje e pashpallur" xhentëlmenësh " mes Enverit dhe Titos, për të bërë sikur e luftonin dhe e urrenin njëri-tjetrin, e nga ana tjetër, të sundonin të qetë në shtetet e tyre?! Ndoshta, këto pyetje dhe shumë të tjera si këto, meritojnë të sqarohen në një tjetër shkrim, por sidoqoftë, në mbyllje nuk mund të mos përmendim qeverinë e LDK-së së dr. Rugovës, Presidentit proverbial, këtij vizionari të madh e të pa lëkundur për një Republikë të Pavarur të Kosovës, me Bukoshin kryeministër, që organizoi FARK-un dhe arsimin shqip pas mbylljes së shkollave nga krimineli Millosheviç. Zhvillimet kulmuan me krijimin e UÇK-së me mijëra luftëtarë e me qindra dëshmorë në sa e sa beteja, ku shkëlqen eposi dhe legjenda e Jasharajve në betejën e Koshares. Pritjen vëllazërore unikale nga ne, të gati një milion bashkëkombësve tanë, të deportuar me dhunë nga ushtria, milicia e paramilitarët serbë dhe në fund, mirënjohjen e thellë e të përjetshme ndaj SHBA-së e NATO-s për çlirimin e Kosovës, çuarjen e kriminelëve serbë si Sllobo, Karaxhiçi, Mlladiçi dhe Shesheli, në Gjykatën e Hagës, shpalljen e Shtetit të Pavarur, plot 10 vite më parë, të njohur deri më tash nga 115 shtete të Botës, Pavarësi e paguar me aq gjak e sakrifica, mbi 10.000 të vrarë, mijëra të zhdukur, mijëra gra e vajza të përdhunuara, e mijëra shtëpi të djegura e të shkatërruara. Kosova ka qenë, është dhe meriton të jetë pjesë e një Europe të Bashkuar e Demokratike, për shkak të vokacionit të saj të përjetshëm perëndimor, si i gjithë kombi shqiptar.

(Historian, ish-ambasador dhe diplomat i karrierës)

Udhëzimi i Këshillit të Ministrave: Si do të bëhet vlerësimi i maturantëve

Zbardhen datat përfundimtare të provimeve të Maturës Shtetërore

"Ja sa pyetje do të kenë testet me detyrim dhe me zgjedhje"

Voltiza Duro

Janë shpallur datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sipas një udhëzimi të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Respektivisht është vendosur që në 4 qershor 2018-të, të zhvillohet provimi i parë për maturantët, ai i gjuhës së huaj që do të pasohet nga testimi i lëndës Gjuhë shqipe dhe Letërsi 4 ditë më vonë. Ndërkohë sipas udhëzimit të publikuar në Fletoren Zyrtare, maturantët e këtij viti, do të zhvillojnë në datën 13 qershor provimin e matematikës dhe do ta mbyllin këtë cikël testimesh në 20 qershor 2018-të ku do të provojnë njohuritë e tyre në lëndët me zgjedhje. Provimet e Maturës Shtetërore 2018 do të fillojnë në orën 10:00 ku ato me detyrim do të zgjasin 2 orë e 30 minuta, ndërsa testi me zgjedhje do të zgjasë 3 orë. "Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja. Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë",-theksohet në udhëzimin e Këshillit të Ministrave. Ndërkohë në këtë të fundit bëhet me dije se testi për secilin nga provimet me zgjedhje përmban 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë, testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë. Gjithashtu, nënvizohet se maturantët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2018, do t'i rijapin provimet në sesionin e dytë. "DAR/ZA-të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2017-2018, dhe brenda datës 2 qershor 2018, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online, sipas udhëzimit përkatës. Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik",-thuhet në udhëzim. Ndërkaq, drejtoritë e shkollave po njoftojnë maturantët mbetës që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2018, pa likuiduar më parë provimet e klasës. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare do të tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Sipas udhëzimit, provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2018 do të zhvillohen në mjediset e institucioneve arsimore, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018 në Republikën e Shqipërisë.

PROVIMET E DETYRUARA

"Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë", - theksohet në udhëzimin e Këshillit të Ministrave.

UDHËZIM
Nr. 10, datë 23.2.2018

PËR DATAT DHE ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2018

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2018, të jenë:
a) Gjuhë e huaj (D3) 4 qershor 2018
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1) 8 qershor 2018
c) Matematikë (D2) 13 qershor 2018
d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2) 20 qershor 2018

2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2018 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018, miratuar me udhëzim nr. 672, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, brenda muajit mars 2018, të përcaktojnë llojin e testeve për secilin provim [illegible]

secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë, testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.

4.7 Maturantët/kandidatët që do të japin provim vetëm njërën nga lëndët me zgjedhje, e fillojnë provimin në orën 11:30 dhe e përfundojnë atë në orën 13:00.

4.8 Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2018, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

5. DAR/ZA-të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2017–2018, dhe brenda datës 2 qershor 2018, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online, sipas udhëzimit përkatës. Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

5.1 Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2018, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

5.2 Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzim e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë".

5.3 Teza e provimit "Gjuhë dhe letërsi greke" për shkollën e mesme pedagogjike të pakicës kombëtare greke të përgatitet nga DAR Gjirokastër.

5.4 Teza e provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e letteratura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe [illegible]

Faksimile e udhëzimit të Këshillit të Ministrave

LËNDËT DHE DATAT PËR PROVIMET E MATURËS

■ **SHTETËRORE 2018, TË JENË:**

a) Gjuhë e huaj (D3) 4 qershor 2018

b) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1) 8 qershor 2018

c) Matematikë (D2) 13 qershor 2018

d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2) 20 qershor 2018 2.

HAP health for all project

Call for: Consultancy for implementation of the accreditation standards at Primary Health Care

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (SwissTPH), and the two NGOs: Terre des hommes (Tdh) and Save the Children (SC) through HAP Center. Its overall goal is that the Albanian population, benefit from better health due to improved Primary Health Care (PHC) services and health promotion activities.

Recently, the Ministry of Health and Social Protection (MOHS) and National Center for Quality, Safety and Accreditation (NCQSA) have introduced the PHC accreditation initiative. According to this initiative all health centers (HC) are required to conduct a first self-assessment, results of which will be use to evaluate the level of implementation of the accreditation standards and identification of the gaps. For supporting the development process of the missing documents required for the accreditation of health centers, **HAP project is seeking the professional service of a qualified and experienced NGO**.

The interested providers should submit a proposal answering the requisites as described in the ***Terms of References*** which can be found in the below link
http://www.hap.org.al/index.php/opportunities-for-cooperation-2/

The bidders for this contract should submit to the HAP Centre the following documents
1. Evidence of experience proved through:
   - o Copy of the registration of the organization
   - o Professional CV of the organization
   - o CVs of main trainers that will be engaged in the implementation
2. Technical offer describing the approaches to be adopted for carrying out the activities
3. Financial offer for the implementation of the proposed approach
4. Working plan for implementation of the activities

Deadline for application

Application should be submitted within **11th of May 2018**, ***in sealed envelopes,*** with subject "**Consultancy for implementation of the accreditation standards at PHC**" to the address:

HAP Centre
Procurement Team
Street" Themistokli Gëmenji"
Helios Building, 2nd Floor, Apt. 5
Tirana, Albania

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

HAP health for all project

Call for: Training of the Health Center's Management Team on planning, implementation and monitoring of health services in Dibra and Fier region

Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by Health for All Centre in Fier and Diber Regions. Its overall goal is that the Albanian population, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

As part of the strategy to improve the quality of Primary Health Care (PHC) services in the two Regions, HAP will contract an experienced NGO to provide a short term training and coaching in Annually Planning, Implementation and Monitoring of Health Services for the managerial teams of Health Centres from the two regions. The potential providers should submit a proposal answering the requisites as described in this TOR that can be found at the below link:
http://www.hap.org.al/index.php/opportunities-for-cooperation-2/

The offer should include:
1. Evidence of experience proved through:
   - o Copy of the registration of the organization
   - o Professional CV of the organization
   - o CVs of trainers that will be engaged in the implementation
2. Financial offer for the training daily fee
3. Financial offer for the coaching session fee
4. Transport cost (fee / km)
5. Technical offer describing the approaches to be adopted for carrying out the activities

Deadline for application

Offers should be submitted in sealed envelope, with subject "**Training of the Health Center's Management Team**" within **11th of May 2018, 4pm,** to the address:

HAP Centre
Procurement Team
Street "Themistokli Gërmenji", Helios Building, Floor 2, Apt. 5
Tirana, Albania
www.hap.org.al

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

VIP Pages
Suplement
E mërkurë 9 Maj 2018 GAZETA SHQIPTARE

HERION MUSTAFARAJ:

Jeta pas divorcit, vajzës i kam dhënë shumë mbështetje

"Njeriu duhet të jetojë dhe të krijojë një jetë më të mirë , pavarësisht ëndrrave, apo profesionit"

Shtatzënisë i vjen fundi, ja 'ç'kurdis' Emina Cunmulaj me të shoqin

Vjen së shpejti "Girls", Rita Ora dhe Bebe Rexha në një këngë së bashku

Flet aktori: Vij me 'show'-n "Jashtë nga Broadway", risia për shqiptarët

Herion Mustafaraj: Jeta pas divorcit, vajzës i kam dhënë shumë mbështetje

"Njeriu duhet të jetojë dhe të krijojë një jetë më të mirë, pavarësisht ëndrrave, apo profesionit"

ELSA DODA

Herion Mustafaraj është një personazh shumë i dashur për publikun shqiptar. Të gjithë e njohim si Beni pasi ka lënë gjurmë në memorien tonë si djali çamarrok në filmin e famshëm shqiptar "Beni ecën vete". Edhe pse prej 27 vitesh vazhdon jetën e tij në Amerikë nuk i ka munguar skenës shqiptare me projekte të ndryshme. Këtë herë Herioni mendon ta suprimojë publikun shqiptar me një show të tijin "One man show" ku do të sjell me humor një ndërthurje të dy botëve, Shqipërisë dhe Amerikës. Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta shqiptare", ai tregon me tepër mbi këtë komedi muzikore, e cila titullohet "Jashtë nga Broadway" dhe nuk ngurron të rrëfeje me tepër mbi jetën e tij në Amerikë, filmat që ka luajtur apo marrëdhënien e tij me të bijën.

Herion, një brez i tërë është rritur duke parë filmin e djalit çapkën "Beni ecën vetë". Si po ecën Beni në SHBA?

Beni ishte djalë mamaje dhe u bë çapkën pasi njohu boteen. Ne kemi qenë dy vëllezër unë dhe Beni. Unë mbeta ndërsa Beni iku duke gjetur jetën, të vërtetën dhe unë tani përfaqësoj Benin. Beni në Amerikë po ecën me hapa vigane. Nga njeri cep i kontinentit në tjetrin ku ta çojëpuna dhe për pak e del në pension. Ç'ke me të, e ka në rregull jetën ai. Pensionin amerikan në xhep. Po ne këtu si do ia bëjmë me pensionet thuaj... Atë më thotë dhe Beni." Ç'të duhet andej Herion, hajde këtu tek vëllai jot. Njerëzit atje ku të ikin një orë e më parë nga sytë këmbët, ti shkon t'u tregosh art e t'u flasësh për mua. Nuk do të dëgjojë njeri vëlla ...atje vetëm politikë dëgjojnë dhe pinë kafe- raki nga mëngjesi deri në darkë. Do bëhesh si monument kulture më thotë. Do ruhesh nga klubi i lagjes për të bërë foto me fansat e mi.

Kanë kaluar kaq vite dhe ende ju njohin si Beni. Ju bezdis ky etiketim?

Si Beni më njohin vetëm në Shqipëri. Kur lëvizim dimensioni i botës zmadhohet dhe e kupton që ata që më njohin si Beni janë si familje dhe tjerët s'më njohin fare dhe më vjen mirë për këtë gjë.

A ngjani si karakter me ndonjë nga rolet që keni luajtur?

Patjetër ngjaj, sepse mbi të gjitha është një dedikim që njeriu i vetvetes për të shprehur atë që është në pozicione të ndryshme dhe periudha kohë të ndryshme. Aktrimi nuk është gjë tjetër përveçse të besosh në atë që bën dhe kur ke mjeshtra si artistët që kishim, të cilët prodhonin filmin shqiptar kupton që është shumë e lehtë të besosh në atë që bën. Ata ta bënin si një histori që po të ndodh ty dhe ti mbi atë prodhon, por je ti që e përshkruan këtë karakter dhe ndërton figurën artistike.

Ju keni marrë pjesë edhe në spektakël kërcimi, a ju duket anakronike me ato në Amerikee?

Nuk më duket anakronike, por më duket moderne. Mua me ka pëlqyer në sensin artistik pasi kisha nderin të imitoja karaktere që i kam parë, ndjekur dhe kam qenë kurioz për to se si e kanë bërë artin e tyre. T'i shprehësh ata duhet të futesh në natyrën e tyre. Pavarësisht se ti do futesh në lëkurën e tjetrit ke diçka tënden pasi çdo artist shpreh veten e vet mbi to. Pra, s'duhet të kesh frikë të bëhesh interesant edhe pse po imiton dike tjetër. Normalisht s'do jetë motoja e jetës sime që të imitoj gjithë jetën psh "George Miçhael" në klube nate apo të vishem si ai, por për një natë në skenë është shumë bukur dhe tregon për me tepër aftësinë.

Herion ju keni një vajzë, Dean. Si ka ndryshuar marrëdhënia juaj me të pas divorcit?

Nuk ka ndryshuar asgjë, vajza ishte pothuajse 14 vjeç kur u divorcuam, dhe nuk ndryshoi asgjë, sepse besoj se një marrëdhënie e hapur ndihmon fëmijët, siç me ka ndihmuar dhe mua. I kam dhënë shumë mbështetje dhe ajo nuk do jetë kurrë vetëm. Për çdo problem do më pyesë mua, sepse dhe unë kam qene aty ku është ajo. Unë jam rritur me prindër të ndarë që në moshën 2 vjeçare dhe shumë gjëra i kam zgjidhur gjatë rritjes time, sepse s'kam pse të jem ndryshe nga të tjerët. Është një fenomen që i ndodh botës, mund të mos jetë faji tek njerëzit, por mund të themi që martesa ka dalë nga moda. Jam pro bashkëjetesës, sepse dhe tani qe jemi të divorcuar nuk ndiejmë ndonjë ndryshim përveçse një liri, mirësjellje dhe mirënjohje që kemi ne të dy me njëri- tjetrin si ish-bashkëshortë për fëmijën tone të mrekullueshëm.

Tani që vajza juaj është rritur, mendoni se do ndjekë gjurmët e babait?

Të gjithë prindërit që kanë parë fëmijët duke u rritur dhe u kanë ndenjur afër çdo ditë ne jetën e tyre, e njohin shumë mirë se kush është, e njohin si personalitet dhe çfarë ëndrrash ka disi. Dhe unë e di që vajza ime është një shëmbëlltyrë e imja, por në të vërtetë do doja që ajo të ndjekë diçka tjetër përtej artit. Për mua arti është një zanat pak si borgjez në shije, duhet të jesh shumë me fat apo të kesh atë luksin qe ta besh ndryshe. Si artist mund të jesh shumë i zgjuar dhe i aftë, por shanset për të gjetur punë janë shumë të vogla.

Ju po vazhdoni me jetën mes SHBA-së dhe Shqipërisë, me çfarë merreni ne Amerikë?

Zanati im si artist më jep komoditetin të përformoja aty ku kam audiencë, dhe më ndodh ngaqë jam 27 vjet ne Amerikë mes

miqve të mi, mes njerëzve që kam lënë gjurmë dhe që kam punuar me ta të më ftojnë në punë të ndryshme. Pavarësisht se Shqipëria është vendi im, këtu është më e vështirë se në Amerikë që të çash në treg, tv show dhe këtë e kam provuar në kurrizin tim. Në Amerikë merrem me çdo lloj pune që të më dali. Njeriu duhet të punojë kudo dhe përveç ëndrrave që ka dhe dëshirave duhet të jetojë mbi të gjitha dhe të krijojë një jetë më të mirë. Edhe sot këtu ka ndryshuar koncepti, s'do të thotë që ke një profesion dhe duhet të qëndrosh në atë deri në vdekje edhe nëse ai profesion të lë në mes të rrugës dhe fillon të kërkosh lëmoshë.

I keni ndjekur zhvillimet e fundit ne Shqipëri mbi zhvendosjen e Teatrit Kombëtar dhe revoltën e artistëve? Ju si e shihni debatin e krijuar mes artistëve dhe ministrisë së Kulturës?

Ai është një institucion që mban brenda një shpirt të shqiptarëve,

artistëve tanë dhe të krijimeve që kemi pasur në fushën e artit dhe kulturës. Në të vërtetë është asgjë, thjesht disa mure të dala nga çatia një metër diferencë që mund të shembej nga koha në kohë, ku poshtë nën atë skenën që rrotullohet këndojnë bretkosat ku disa nga ato kanë bërë një zë akoma më të fortë se aktorët. Ndonjëherë bretkosa ka më shumë ego se aktori në skene. Nëse një ndërtesë nuk ka vlera historike apo arkitektonike dhe të shprehi kulturën e një populli ajo patjetër duhet të kthehet në një mit të së djeshmes. Disi duhet të bëhet diçka e re që të shprehi interesat dhe vlerat e vërteta të artit të momentit të kulturës sonë, artistëve, asaj çka ne duhet të luftojmë dhe çka duam të jemi. Ashtu siç thotë dhe Dritëroi i famshëm tek "udhëtoj i menduar" "diçka duhet të përmbysim në emër të jetës së lirë që jeta mos të dergjet mes ndrojtjes strukur, që jeta t'i dali përpara jetës mirë dhe brezat që vijnë të thonë me plot gojë, "bukur".

Cili është projekti yt i radhës në Shqipëri, po merresh me diçka aktualisht?

Kam shumë projekte që nga personalet deri te artistiket. Te artistiket jam duke prodhuar një show timin që e kam shfaqur në Amerike dhe e kam testuar tre herë në New York, dua ta bëj të ndjeshëm për shqiptarët në Shqipëri. Është një komedi muzikore e stilit one man show, domethënë me një aktor që jam vetëm unë dhe titullohet "Jashtë nga Broadway". Dua të sjell skena të përfytyrimit që karakteri, "xhaxhi Dule" sjell mbrapsht jetën e tij në skenë duke krahasuar midis ëndrrave dhe realitetit në atë çka njeriu ndjekë në jetë dhe çfarë ka mësuar ai në jetën e tij që duhet të bej. Në fund fare xhaxhi Dulja me gjak shqiptari, siç jemi ne shqiptarët, merr guximin dhe bëhet ai që ëndërronte të bëhej, dhe kjo ka tragjeditë e veta në skenë që spektatori do i shohë dhe do kënaqet .

Na flisni pak rreth këtij show, kur pritet të shfaqet?

Premiera e showt u dha në Producer's Çlub Theaters në New York city në shkurt të 2018. Kjo komedi muzikore fillon rrugëtimin e vet në Shqipëri këtë pranvere të 2018 si dhe në Evropë më pas, ku ndodhen komunitete shqiptare. Show është në gjuhën shqip e në anglisht nëse shfaqet për audiencë të huaj jo shqipfolëse. Përmes karakterit kryesor që është një teknik pianosh në moshe të thyer xha Dules, unë do sjell me humor një ndërthurje të dy botëve, Shqipërisë dhe Amerikës ku problemet sociale, familjare e personale të njerëzve janë pothuajse të njëjta në sytë e individit që prek këto tema mes monologëve komike në skenee. Me mesazhin-"Nuk ekziston një dështak që provon", dua të zgjoj tek spektatorët ndjenjën e vlerësimit për mundimet e sakrificat njerëzore, rrugën e vështirë të emigrimit për një jetë më të mirë, respektin ndaj të moshuarve si dhe teori të ndryshme të të jetuarit të jetës duke i sjellë këto monologë në skenë me një protagonist komik. Ky show pretendon të jepet në teatrot më të mëdha të Shqipërisë si në kryeqytet ashtu edhe nëpër rrethe si Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Shkodër e Prishtine.



Ke marrë pjesë në disa filma amerikanë siç janë "Bird poop", "Cash Only", "Killarman", "Being,American", "War Stories", "Trace" çfarë rolesh ke luajtur kryesisht?

Tek filmi Killarman unë luaj me aktorin Liam Helmswoth, Çohen, Nick Shreli etj. me të cilët kemi bërë një punë shumë të mirë. Unë luaj rolin e Nikos, shoferi i Bosit të një dyqani diamantesh në NY. Filmi është action/thriller dhe u xhirua ne New York dhe në Savanah Georgia. Pritet të dalë në Movie Theaters këtë shtator.

Filmi i fundit përpara Killerman është "Cash Only" dhe shfaqet në Netflix. Unë kam një nga rolet e spikatura dhe quhem Agron. "Cash Only" është prodhuar në Amerikë nga lobi amerikano - shqiptar i Detroitit, duke sjellë një tjetër këndvështrim të jetës amerikane. Filmi është fitues i shumë çmimeve në festivalet ndërkombëtare të filmave. Ndërsa ne filmin "Bird Poop" jam, gjithashtu, skenarist e producent.

SHTATZËNISË I VJEN FUNDI, JA 'Ç'KURDIS' EMINA CUNMULAJ ME TË SHOQIN

Kemi pothuajse 9 muaj që jemi duke "hetuar" lart e poshtë lidhur me shtatzëninë e modeles shqiptare me famë ndërkombëtare, Emina Cunmulaj. Dhe këtyre 'kontrolleve' ua shtonjnë herë pas here kuriozitetin edhe postimet e vetë modeles, e cila na vë shpesh në dilemë lidhur me gjininë e fëmijës që ka në bark. Edhe pse ka qenë vetë ajo që kohët e fundit ka pranuar që ende nuk e di dhe nuk ka dashur ta zbulojë gjininë duke e lënë mister deri në ditën që do të lindë. Ndërkohë, vijojnë vizitat tek gjinekologu. Pikërisht ditën e djeshme ajo ka shkuar bashkë me bashkëshortin për të bërë kontrollin e radhës. Por ajo që na ka tërhequr më tepër vëmendjen është videoja që Emina postoi me mbishkrimin "Vizita e madhe". Mos do të thotë kjo që dje ata kanë zbuluar edhe gjininë e fëmijës, që shumë shpejt do të vijë në jetë? Të jetë djalë apo vajzë? Ende mbetet për t'u parë.





KOHË E VRENJTUR, POR MIRIAMI POSTON FOTON QË DO JU NGROHË ZEMRAT

Edhe pse vijojnë ditët me shi dhe padyshim që ndikon edhe në humorin e njerëzve, të shumtë kanë qenë VIP-at tanë, që kanë preferuar të postojnë në faqet e tyre në "Instagram" foto nga ditët e vrenjtura. Por ndryshe nga të tjerët, ka qenë këngëtarja e njohur Miriam Cani, e cila ka dashur të "ngrohë" pak me një foto të ëmbël. Dhe kush tjetër mund të sjellë kaq shumë ëmbëlsi se sa vogëlushja e saj, Ameli. Në një foto ku shihet e mbështetur në dritare, këngëtarja shkruan: "Edhe diell... edhe shi... si do t'ia bëjmë kësaj kohës ne"? Sa shumë ëmbëlsi në një foto!

RENATO MEKOLLI: SË SHPEJTI DO TË VIJ ME NJË "REALITY SHOW"

Ai padyshim që është një nga shefat më të mirë në Shqipëri dhe jo vetëm. Renato Mekolli njihet edhe si një figurë televizive, pasi u bë shumë i dashur për publikun nga pjesëmarrja si anëtar jurie në disa edicione të "MasterChef Albania". Për revistën "Bordo", Renato ka treguar se së shpejti do të vijë në ekran me një "reality show". Ai ka treguar se programi ka lidhje me kuzhinën, por nuk është si të tjerët që kemi parë. Ndërsa për televizionin ku do të fillojë ky 'show', akoma nuk është bërë me dije. Me siguri që do të ketë sukses. Presim të shohim ç'risi do të sjellë kuzhinieri karizmatik së shpejti.

VJEN SË SHPEJTI "GIRLS", RITA ORA DHE BEBE REXHA NË NJË KËNGË SË BASHKU

Të gjitha i mirëpresim tashmë, por që të vinin kaq sjpejt, jo! Dy këngëtaret me origjinë shqiptare, Bebe Rexha dhe Rita Ora, për herë të parë bashkëpunojnë për të sjellë një këngë së bashku. Kënga është realizuar edhe në bashkëpunim me dy këngëtaret e famshme Charlie XCX dhe Cardi B. Këngëtaret e famshme janë bërë bashkë për të sjellë këngën "Girls", që do publikohet më 11 maj. Rita Ora pritet të sjellë albumin e saj këtë vjeshtë, duke ndjekur debutimin e saj në 2012.

57-vjeçari Xhafer Osmani

Kosovari i shkrumbuar brenda në makinë, policia: Dyshohet se është krim pasioni

FUSHË KRUJË - Pesë ditë pas djegies në makinë të 57-vjeçarit Xhafer Osmani në fshatin Borizanë të Fushë-Krujës, policia ka zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë. Burime nga grupi hetimor dje bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se në krah të makinës, brenda së cilës u gjet i shkrumbuar viktima nga Mitrovica, është gjetur një libër i shenjtë (Kurani). Mësohet se libri i shenjtë është gjetur i padëmtuar nga zjarri. Ndërkohë, policia ka marrë shenjat e gishtave të gjendura mbi të. Po të njëjtat burime pohuan se ka dyshime se viktima është detyruar të betohet mbi librin e shenjtë dhe se ngjarja është krim pasioni. Madje, hetuesit dyshojnë se konflikti ka nisur që në Kosovë. Në të njëjtën kohë janë verifikuar lëvizjet e Osmanit. Konkretisht, 57-vjeçari ka hyrë edhe në janar në Shqipëri me mjetin e tij. Në atë kohë ai shoqërohej me 2 persona të tjerë kosovarë, ndërsa ka qëndruar 1 javë në një hotel në Durrës. Edhe këtë radhë, pra me hyrjen e tij më 29 prill në Shqipëri, u regjistrua në të njëjtin hotel. Por, që prej asaj dite nuk ka më të dhëna për lëvizjet e Xhafer Osmanit. Gjithashtu, burimet e mësipërme u shprehën se ka dyshime se familjarët kanë dijeni për konfliktin që ka pasur Osmani, por ata nuk flasin. Familjarët njoftuan policinë një ditë para zhdukjes, ndonëse ai kishte disa ditë që ishte larguar nga shtëpia. Ndërkaq, burime policore nuk përjashtojnë dhe mundësinë e vetëvrasjes së kosovarit.

Reagon prokuroria: Nuk kishte materiale që klasifikohen sekret shtetëror

Grabitet posta sekrete e Prokurorisë së Durrësit, korrieri u sulmua nga 2 persona

Punonjësi: Më goditën në mënyrë të befasishme

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Posta sekrete e Prokurorisë së Durrësit është grabitur nga persona ende të paidentifikuar. Burime zyrtare nga policia vendore bënë me dije se ngjarja ndodhi paraditen e djeshme në lagjen nr.11 të qytetit bregdetar, pranë filialit të postës. Mësohet se dy persona me kapele në kokë (sipas dëshmive paraprake) kanë sulmuar korrierin e prokurorisë me inicialet I.K. dhe i kanë marrë me forcë çantën me disa materiale, që sapo i kishte marrë nga posta. Menjëherë pas krimit, agresorët u larguan me shpejtësi. Pas sinjalizimit për grabitjen, policia dhe përfaqësues të organit të akuzës mbërritën në vendngjarje dhe nisën hetimet. Blutë kanë marrë dëshminë e korrierit, i cili pohoi se personat e goditën në mënyrë të befasishme. Më pas ata i morën materialet dhe u larguan me shpejtësi. Ende nuk dihet se çfarë përmbajtjeje kishin materialet e postuara, por burimet thanë se bëhet fjalë për dokumente me karakter hetimor sekret. Hetuesit e çështjes kanë sekuestruar pamjet filmike të kamerave të sigurisë në zonën ku ndodhi ngjarja, me qëllim identifikimin e autorëve. Nga ana tjetër, Prokuroria e Durrësit deklaroi se nuk ka pasur materiale, të cilat klasifikohen si sekret shtetëror. "Lidhur me

Prokuroria e Durrësit

rastin ju informojmë që kjo ngjarje ka ndodhur sot (dje) rreth orës 10:30, ku punonjësi i postës së Prokurorisë Durrës ka qenë objekt i sulmit nga persona të paidentifikuar. Po kryhen veprimet hetimore me përparësi për verifikimet e rastit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë të Qarkut Durrës. Duam të theksojmë se nga përmbajtja e akteve të mara nuk cenohet hetimi për ndonjë nga çështjet dhe nuk ka pasur materiale, të cilat klasifikohen si sekret shtetëror. Për momentin në mirëkuptimin tuaj për shkak të hetimit që po kryhet dhe sekretit të tij nuk mund të japim më shumë të dhëna", thuhej në njoftimin zyrtar të Prokurorisë së Durrësit.

PD: Grabitja, akt i paprecedentë, Marku të sqarojë a ka lidhje me Dakon

TIRANË - "Një akt i paprecedentë në historinë e shtetit shqiptar". Kështu e cilëson deputeti i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj, grabitjen e postierit ditën e djeshme në qytetin e Durrësit. Në një deklaratë për mediat, ai tha se asnjëherë deri më sot nuk kishte ndodhur që të grabiteshin dokumentet shtetërore dhe me përmbajtje sekrete. Sipas Alibeajt, një ngjarje e tillë është dëshmi e bashkëpunimit të krimit me shtetin. "Akt i paprecedentë në historinë e shtetit shqiptar. Nuk ka ndodhur të grabiten dokumentet shtetërorë as ditën, as natën. Kjo është dëshmia më e rëndë bashkëpunimit të krimit me shtetin. Bashkëpunimi i krimit me shtetin ka arritur në nivele të tilla, sa krimi di jo vetëm përmbajtjen e dokumenteve sekrete, por edhe vendin dhe orën kur ato do të tërhiqen në postieri. I bëjmë thirrje prokurorisë të informojmë menjëherë publikun çfarë përmbante posta sekrete, cili ishte dërguesi dhe kush ishte marrësi. Të thuhet a ka lidhje posta sekrete e grabitur me Vangjush Dakon? A ka lidhje me hetimin e rastit të trafikut të drogës nga Durrësi?", u shpreh deputeti demokrat.

Kokaina nga Spanja, zbulohet shqiptari, pronar i marketit në Itali

ITALI - Policia italiane ka zgjeruar operacionin kundër bandës që trafikonte drogë nga Spanja në Itali, ku pjesë janë edhe shqiptarë. "Cesena Today" raporton se droga vinte nga Spanja përmes Francës dhe më pas paketohej e ndahej për shitje me pakicë. Ajo dorëzohej në një market që shiste fruta dhe perime dhe ishte pronë e një shqiptari, emri i të cilit nuk bëhet ende i ditur. Shqiptari, i cili u zbulua nga përgjimet e policisë, dhe një kushëriri i tij me lidhje të forta në rrjetin e trafikut të drogës ishin përgjegjës për pritjen dhe më pas shpërndarjen e drogës së ardhur. Figura kyçe e grupit ka qenë një sicilian që vepronte mes Rimini, Forlì, Cesenatico dhe Cervia dhe siguronte shpërndarësit e drogës për shitje në rrugë. Karabinierët kanë dokumentuar mbi 2 mijë episode të trafikut për një qarkullim që llogaritet në mbi 1 milion euro, shkruan "Cesena Today".

Mariglen Muka

Dyshonin për vjedhje në fshat, 34-vjeçari: Më dhunuan me grushte e shkelma në komisariat

KORÇË - Një 34-vjeçar nga fshati Kamenicë i Korçës pretendon se është dhunuar në ambientet e Komisariatit të Policisë së Korçës. Bëhet fjalë për Mariglen Mukën, i cili thotë se është shoqëruar në komisariat si i dyshuar për disa vjedhje, por është dhunuar nga polici që e ka marrë në pyetje, madje ka humbur edhe ndjenjat. "U paraqita në komisariatin e Korçës rreth orës 9 të mëngjesit, sepse më telefonoi inspektori i zonës. Mendova se më kërkonin për dokumentet e makinës. Më shoqëruan në një prej zyrave të komisariatit, ku më morën në pyetje për disa vjedhje në fshat dhe kërcënimin nëpërmjet telefonit. Kur mohova akuzat, polici që më mori në pyetje, më fyeu dhe më pas më goditi me grushte dhe shkelma në kokë dhe pjesën e barkut. Nga goditjet humba ndjenjat. Pasi u përmenda, më çuan në një tjetër zyrë dhe aty erdhi një mjek më bëri një qetësues, sepse kisha shqetësime. Më lanë të lirë rreth orës 15 dhe familjarët më sollën në spital. Po bëj analizat dhe kontrollet mjekësore. Do bëj denoncim për policin që më dhunoi. Kur u dhunova, prezent ishte edhe inspektori i zonës, por ai nuk më goditi", - thotë Mariglen Muka. Ndërkaq, SHÇBA ka filluar verifikimet për policin që dhunoi 34-vjeçarin dhe inspektorin e zonës. Burime konfidenciale nga policia e Korçës pohuan për "GSH" se dy efektivët kanë mohuar të kenë ushtruar dhunë mbi të riun, edhe pse në fytyrën e tij, pasojat e dhunës janë të dukshme.

PERKUJTIMI

GJON KUJXHIJA

Vdekja e trishtë e muzikantit në Firence dhe vepra e mohuar në komunizëm

Një botim për studimin e 1940-ës, që mblodhi thesaret e valleve dhe ahengut shkodran

Eno Koço: Studimi për vallen kombëtare dhe Epiri, atje ku lëvrohej vallja e hershme pirrike

Fatmira NIkolli

Ishte orkestrina familjare e formuem nga vllaznit: Ndoc, Gjon e Lin së bashku me kushrinin tonë, muzikantin popullor, Rud Gurashi, që formojshin orkestrinën mandolinatë. Ndër raste datëlindjesh e emnash, u mblidhshin të gjithë në shtëpinë tonë, e aty me kangë të bukura familjare, e me pjesë nga melodramat e kompozitorit të talentuem Dom Mikel Koliqi e klasike, shpërthente entuzjazmi i të gjithvet. Mandej ky grup do t'u kthente në kor serenatë, tue përcjellë nëpër shtëpija miqt e ftuem. Kangët e Schubertit- si Serenata ose 'Va pensiero' e Verdit, ushtojshin armonishëm nëpër rrugët e zbrazta të qytetit".

Në një familje si kjo, u rrit në Shkodër Gjon Kujxhija. Pothuaj një emër i panjohur që jetoi pak, por para se të ikte nga kjo jetë krejt i ri, la pas një trashëgimi të pasur kulturore. Për ta kujtuar për ata që e kanë njohur dhe për tua prezantuar atyre që nuk e dinë kush është, të premten në orën 11:00 në Akademinë e Shkencave do të promovohet botimi kushtuar Gjon Kolë Kujxhisë. I shoqëruar me shkrime historike për figurën dhe kontributin e tij ribotohen njëherësh në mënyrë fototipike studimet e tij të viteve 1940 "Valle Kombëtare dhe ahengu shkodran". Libri është edituar nën përkujdesjen e Prof. As. Dr. Eno Koço "Nderi i Kombit", ndërsa për botimin flasin prof. as. dr. Eno Koço, Dr. Tonin Çobani, Dr. Mikaela Minga dhe dr. Admir Ballgjati, nën moderimin e akademikut Vasil Tole. Kush ishte Kujxhija, djaloshi që ndonëse u shua në moshën 23-vjeçare la pas një vepër që ende sot, vlerësohet për çfarë ka përçuar deri në ditët tona?

JETA E SHKURTËR E

VDEKJA E TRISHTË

Pat lindur më 11 maj 1920. Sipas Tonin Zadesë, shtëpia e Kolës, të atit të Gjonit, ishte 'skena e parë ku vëllezërit, motrat dhe bashkëmoshatarët e familjeve fqinjë me ta, këndonin dhe recitonin'.

Ndërsa Injac Kujxhija, i vëllai kujtonte: "Gjoni me anë të disqeve na njofti me muzikantat e mëdhenj botnor si: Bach, Händel, Mozart, Beethoven, Schubert, Verdi etj'. Grupit familjar të Kujxhijave iu shtuan më vonë edhe djem dhe vajza të lagjes Gjuhadol, lagje kjo e mirënjohur e Shkodrës. Në këto argëtime ku fëmijët e të rriturit luanin në instrumente e këndonin në kore nën melodité e valleve të kënduara të martesës e të shregullave, Gjoni mjaft natyrshëm vihej në rolin e organizuesit së 'shfaqjeve', të cilat shpërbleheshin me duartrokitjet e prindërve të fëmijëve pjesëmarrës. Gjoni 'këndonte shumë bukur si solist e ndër kore, si bas, luante në teatër dhe merrte pjesë në orkestrina me kitarë".

Prirja muzikore iu shfaq që në moshë të njomë. Pas shkollës fillore, Kujxhija i vazhdoi mësimet pranë liceut "Illyricum" të Etënvet Françeskanë. Që në klasat e para të këtij liceu ai tërheq vëmendjen e kompozitorit, organizatorit dhe drejtuesit të veprimtarive muzikore në qytetin e Shkodrës, Atë Martin Gjoka. Krahas mësimeve të përgjithshme në gjimnaz, Gjoni i kushtonte një kohë të mirë thellimit të njohurive të tij me mësimet bazë të muzikës. 'Pas mbarimit të shkollës së mesme (1939) shkoi për studime në konservatorin 'Luixhi Kerubini' në Firence' (Harapi, 'Jeta e re', 1991).

Gjoni pati përparuar shpejt e mirë si në përdorim të veglave muzikore edhe në teorinë e muzikologjisë shkruante Ernest Koliqi në 'Shêjzat' më 1963. Pas përvojës së parë si muzikant ai shkoi në Firence për të studiuar në konservatorin 'Cherubini'.

Studimet e Gjonit u prenë në mes nga një bombardim ajror që përfshiu edhe shtëpinë ku ai banonte e shkruante veprat e tij muzikore. Ishte kjo ngjarje që shënoi ditën fatale të 25 shtatorit 1943. Nëntë muaj më pas, Kolë Ashta do të kujtonte: 'Në një ças iu mbush mendja me shkue kah shtëpija për të krye nji punim muzikuer. Shokët iu lutne që të rrinte me ta. Nuk ndëgjoi. Por sa kishte çelë pentagramat ulurijti kushtrimi ajruer. Edhe këtu iu lutne njerzit e shtëpis. Nuk ndëgjoi të zbresi në strehim me ta'. Ndërsa Koliqi 20 vjet më vonë do të kumtonte se 'Muzicisti shkodran Gjon K. Kujxhija qi në lule të rinís dhe në vlug të fuqive krijuese vdiq tue pasë moshën njizetrivjeçare në bombardimin qi pësoi Firenze me 25 shtatuer 1943' (Koliqi, 'Shêjzat', 1963). U ndërprenë vitet studenteske të Gjonit, u ndërpre muza e tij djaloshare, për t'u zëvendësuar me veprën e tij të papashembullt, të papërsëritshme, unikale në historinë e muzikologjisë shqiptare.

ENO KOÇO

Koço ka marrë përsipër editimin e botimit për Gjon Kolë Kujxhinë.

Me ç'rast thotë se "parathënia e librit 'Valle Kombëtare' përmban shtjellimin teorik të lëndës, shtjellim që përshkohet nga erudicioni i gjerë e guximi i shtrimit të tezave me synimin për të paraqitur një vepër thellësisht kombëtare, si për të përforcuar gjenezën e shqiptarit të hershëm". Për profesor Koçon botimi i librit "Valle Kombëtare" ishte një ngjarje e shënuar për muzikologjinë shqiptare, ishte një afirmim i muzikës tradicionale qytetare shkodrane, e cila edhe pse njihej nga praktikantët e saj, nga bashkëqytetarët e saj, por vetëm në formë gojore, tani do të kishte një referencë të qartë që ashtu si lëmet e tjera të folklorit e visareve të kombit, do të fiksohej në letër e kënduar në shqip, e shkruar shqip dhe e studiuar më së miri në shqip. "Fakti që Kujxhija e lidh vallen e kënduar shkodrane me vallen e jugut shqiptar (Dardhë, Përmet e Labëri) të bën të mendosh se vendosja e titullit të librit 'Valle Kombëtare' dhe jo 'Valle shkodrane' apo 'Dasëm shkodrane', lidhet me vizionin e tij prej 'iliri të ndezun' për të bërë një përgjithësim mbarëkombëtar të nocionit të 'valles', madje duke e shtrirë edhe më poshtë, në Epir, atje ku lëvrohej vallja e hershme pirrike". Profesor Eno, shton me keqardhje se studimet e Gjonit u prenë në mes nga një bombardim ajror që përfshiu edhe shtëpinë ku ai banonte e shkruante veprat e tij muzikore. Ishte kjo ngjarje që shënoi ditën fatale të 25 shtatorit 1943. U ndërpre muza djaloshare e Gjonit për t'u zëvendësuar me veprën e tij të papashembullt, të papërsëritshme, unikale në historinë e muzikologjisë shqiptare.

VEPRA

Në 1943 Gjon Kujxhija botoi në Firenze librin "Valle Kombëtare" (Dasëm shkodrane), vepër kjo krejt e përveçme edhe për ditët e sotme të valleve të kënduara të dasmës shkodrane. Mustafa Krantja në artikullin e tij 'Valle shkodrane' të 26 korrikut 1944 e paraqet kështu librin e Kujxhisë: 'Libri ndahet në tri pjesë: në fillim nji parathanje shumë e mirë në të cilën auktori shoshitë probleme me randësi të madhe të muzikës s'onë. Pjesa e dytë përmban një spjegim të hollësishëm të zakoneve të fejesës e martesës në gjindjen katolike të Shkodrës. Vallet qi titullojnë librin janë rrjeshtue në pjesën e tretë të tij' (Krantja, 'Bashkimi i Kombit', 1944). Pra, ashtu siç e vë në dukje edhe Krantja, Parathënia përmban shtjellimin teorik të lëndës, i cili përshkohet nga erudicioni i gjerë e guximi i shtrimit të tezave me synimin për të paraqitur një vepër thellësisht kombëtare, si për të përforcuar gjenezën e shqiptarit të hershëm, apo siç pohon Kolë Ashta se Gjoni

EUROVIZION

EUGENT BUSHPEPA MAHNIT LISBONËN, KUALIFIKOHET NË FINALEN E EUROSONG

Ka mahnitur me zërin dhe me performancën e tij Eugent Bushpepa mbrëmë në Eurovizion me këngën "Mall". Zëri, interpretimi dhe kënga e tij e çuan Shqipërinë në finalen e Festivalit Europian, që mbahet në Lisbonë më 12 maj. E ka zotëruar skenën dhe salla e ka pritur me ovacione. Eugent Bushpepa ishte i treti që u ngjit në skenë me këngën "Mall" në gjysmëfinalen e parë. Të gjitha komentet e djeshme kanë qenë pozitive për këngën shqiptare. Edhe komentet nga kolegët e tij në Shqipëri kanë qenë më mbështetje të rokerit, që ndër vite ka ruajtur një profil të tërhequr, por duke hedhur hapa të sigurt, si mbrëmë kur arriti notat më larta me një siguri dhe qetësi të mahnitshme. "Altice Arena është zyrtarisht rok falë Eugent Bushpepës", shkruante dje faqja zyrtare e Eurovizionit. Vendet që kaluan në finale janë Austria, Estonia, Qipro, Lituania, Izraeli, Republika Çeke, Bullgaria, Shqipëria dhe Finlanda.

'gjatë bisedës u mundonte me e lidhë mendimin me emnin Ilirí' (Ashta, 'Bashkimi i Kombit', 1944). 'Dokët, Fejesa—Martesa' është pjesa e dytë teorike e librit, ajo që pason Parathanje-n, ku jepen 115 shpjegime mbi këto rituale të hershme vendore. Pas këtyre dy pjesëve të shkruara teorike, vjen notëzimi i 52 valleve të këndurara bashkë me tekstin e tyre poetik që është i vendosur nën nota, ashtu siç është e rregullt të bëhet, por teksti jepet edhe në formën e një vjershe të shkruar më poshtë ku shihet qartë rima, rrokëzimi dhe natyra e vargut. Në fund të faqes vihet dhe shënimi se ku dhe kur këndohet vallja. Ja disa shembuj: *'Me ket valle fillon rituali i martesës. Këndohet kah djali t'ejten paradite'; 'Kurdoherë për fejesë dhe martesë. Edhe në shregull'; 'Me ket melodi edhe vjerrsha tjetër'; 'Kah djali kurdoherë para marteset'*. Të këtilla shënime jepen në fund të çdo valleje të kënduar. Që prej viteve të Shkodrës për të vijuar me ato të Firences, Kujxhija ishte në procesin e krijimit e një vetëdije personale, e cila bazohej e konsolidohej nga burime të ndryshme, të shkruara dhe gojore, duke i dhënë atij gjithnjë e më tepër siguri për t'i hedhur në letër në ato që ai besonte.

Kujxhija që në faqen e parë të Parathanje-s së tij do të shpaloste njohuritë që ai kishte për muzikën në Shkodër, etapat që ajo kishte kaluar ndër shekuj. Ishin njohuri këto të marra nga shkodranë eruditë, njëri nga të cilët ishte 'folkloristi i njoftun dhe muzikanti i vlerët P. Bernardin Palaj'—siç e konsideronte këtë personalitet shkodran Gjon Kujxhija.

Kujxhija i ndante kështu etapat e muzikës: "Në Shkodër, kemi dy soje muzike, ase ma mirë me thânë, dy perjudha të ndryeshme të krijimit dhe të zhvillimit të sajë. I. Fillon prej kohve të lashta dhe arrinë deri te pushtimi i Shqipnisë prej Turkisë. II. Përfshinë perjudhën e pushtimit deri në kohë të sotçme. Së parës i përkasin 'vallet'; së dytës 'kangët e hêngut".

PAK KOPJE DHE NDALIMI

Botimi i librit "Valle Kombëtare" ishte një ngjaje e shënuar për muzikologjinë shqiptare, ishte një afirmim i muzikës tradicionale qytetare shkodrane, e cila edhe pse njihej nga praktikantët e saj, nga bashkëqytetarët e saj, por vetëm në formë gojore, tani do të kishte një referencë të qartë që ashtu si lëmet e tjera të folklorit e visareve të kombit, do të fiksohej në letër e kënduar në shqip, e shkruar shqip dhe e studiuar më së miri në shqip. Fatkeqësia e këtij libri unikal qëndron në atë që jo vetëm u botua në pak kopje, pasi autori donte të vilte mendimin e gjerë intelektual e më pas ta ribotonte me ndonjë ndryshim të nevojshëm, por ajo më e madhja qe se vetëm një vit pas botimit të librit në Firence, në Shqipëri do të vendosej pushteti totalitar dhe Kujxhijat u konsideruan të padëshiruar për sistemin e ri, kësisoj edhe libri i Gjonit do t'i nënshtrohesh persekutimit për të mos u bërë kurrë objekt studimi, për të mbetur i panjohur.

VALLET E KËNDUARA SHKODRANE

Studiuesit kanë shënuar se Kujxhija i transkriptoi me përgjegjshmëri të lartë melodité e 52 valleve të kënduara nga vetë goja e 'atyne trembëdhetë zojave kah ka ndigjue vallet, e prei atyne nandë zotnijve siguristë do ta ketë ndigjue má se 'i herë'—shkruante Injac Zamputti nga Shkodra në tetor të vitit 1943. Burimi i parë i këtyre valleve të kënduara të ritualit të martesës kanë qenë vetë praktikantët lokalë edhe pse duke qenë trashëgimi gojore dhe jo e notëzuar nuk mund të thuhet se varianti i transkriptuar i Kujxhisë të ishte i vetmi që praktikohej aso kohe në Shkodër.

Libri "Valle Kombëtare" është botim i cilësisë së lartë në përmbajtjen e të cilit gjenden melodité e notëzuara me tekstet përkatëse bashkë me studimin dymbëdhjetë faqesh, Diftojsi-n prej dy faqesh, si dhe dy faqe të tjera me tekste këngësh.

SKËNDERBEU NË 37 LIBRA UNIKË, EKSPOZOHET KOLEKSIONI I RRALLË ME BOTIMET TË SHEK. XVI

Në kuadër të "Javës së Europës", Muzeu Historik Kombëtar organizon një ekspozitë mbi figurën e Heroit Kombëtar, i cili ka tërhequr vëmendjen e historianëve, por edhe të shkrimtarëve evropianë përgjatë shekujve. Një numër shumë i madh autorësh, të epokave të ndryshme historike dhe rrymave të ndryshme letrare, i janë përqasur kësaj figure duke krijuar një mori veprash të gjinive dhe lloje të ndryshme letrare. Muzeu Historik Kombëtar çel ekspozitën me koleksionin e Patricia Nugee, i cili përbëhet nga 37 libra unikë. Pjesa e koleksionit të shek. XVI paraqet 12 libra të botuar në mes viteve 1510 dhe 1597. Nëntë prej tyre janë botime dhe përkthime të veprës së Marin Barletit, priftit katolik nga Shkodra, i cili u largua nga qyteti i tij dhe jetoi në mërgim në Itali pas pushtimit osman. Koleksioni fillon me botimin e vitit 1510 të Barletit, me titull "Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, Princit Epirot". Librat e

këtij koleksioni janë botuar në Romë, Augsberg, Strasburg, Venecia, Frankfurt, Londër, Lisbonë, Madrid etj. Një botim i rrallë është libri me autor Dhimitër Frangun, i botuar në Venecia më 1584. Koleksioni i shek. XVII sjell një pasuri të botimeve për heroin tonë kombëtar. Në këtë shekull Skënderbeu shfaqet në disa vepra të këtij koleksioni të rrallë. Mund të përmendim të parën poemë të shkruar për Skënderbeun nga Margherita Sarrochi, e botuar në Romë në vitin 1606 dhe ribotuar në Napoli 100 vjet më vonë; poezitë e Busier-it botuar në Lion, poezitë e fisnikut dhe komandantit ushtarak, Luis de Meneses, viti 1688, botuar në spanjisht dhe portugalisht. Një perlë në koleksionin e znj. Nugee është fjalori i parë shqiptar, një fjalor latinisht-shqip i Frang Bardhit, i botuar në Romë në vitin 1635. Kapitulli i fundit është një koleksion prej 11-faqesh të proverbave shqiptare. Librat e shek. XVIII na çojnë në një udhëtim kulturor në Paris, Amsterdam, Londër, Brescia, Stokholm etj. Jeta dhe veprat e Skënderbeut u kthyen në frymëzim jo vetëm për historianët që studiojnë atë, por edhe për dramaturgët dhe gjinitë e tjera të artit. Skënderbeu i William Havard (1733) ose "Dashuria dhe Liria" (1747) e Thomas Whincop, u publikuan në Londër në këtë shekull. Kjo ekspozitë plotësohet me riprodhimet e Përkrenares dhe Shpatës së Skënderbeut. Gjithashtu, ekspozita përmban statute, faksimile, gravura të autorëve të ndryshëm dhe portrete, me anën e të cilave vizitorët njihen me momente nga jeta dhe beteja të Heroit Kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Një nga anët më interesante të figurës së Skënderbeut është jetëgjatësia e famës dhe lavdisë së tij në periudhat më të rëndësishme të lëvizjeve përparimtare të popujve të Europës dhe të popullit shqiptar. Në historiografinë botërore ndër shekuj janë shkruar shumë monografi të veçanta për Skënderbeun, disa prej të cilave janë botuar si libra më vete. Duke pasur parasysh përmasat europiane të kësaj figure, këto libra japin një panoramë të admirueshme të botimeve për Skënderbeun.

ELENI LAPERI: NDIKIMI I SISTEMEVE POLITIKE NË ARTIN PAMOR

Në biseden e saj në Harabel, një platformë e re për artin pamor në Tiranë, Eleni Laperi do të trajtojë influencat e forta që sistemet politike kanë ushtruar mbi artin pamor në Shqipëri. Ajo do të ndalet në periudhën e komunizmit, për të vazhduar me post-komunizmin dhe tranzicionin. Laperi (lindur në Tiranë në vitin 1949) është studiuese, kuratore dhe kritike arti. Ajo u diplomua për pikturë nga Instituti i Lartë i Arteve në Tiranë në vitin 1972. Laperi u emërua si dizajnere e revistës "Shqiptarja e Re" (1972-1980) dhe e byrosë së modeleve në Ndërmarrjen Kartografike në Tiranë (1980-1989). Në 1989 u

emërua kuratore e Sallonit Shtetëror të Artit, për të kaluar më pas në vitin 1993 në Sektorin e Studimeve në Galerinë Kombëtare të Artit në Tiranë, ku punoi deri në vitin 2000. Është ndër themeluesit e revistës PamorART, botim i Galerisë Kombëtare të Arteve, dhe kryeredaktore e saj (1999) dhe nismëtare e Programit të Edukimit në G.K.A. (2000). Laperi ka kuruar ekspozita të artit pamor në Shqipëri e disa vende të tjera. Është autore e artikujve mbi artin shqiptar, e librave dhe përkthimeve mbi artin dhe kulturën. Së fundmi, Laperi është duke kryer një studim mbi autorin Kolë Idromenon, themelues i pikturës realiste shqiptare dhe mbi zhvillimin e artit shqiptar nga viti 1883 deri më 1945. U zgjodh kryetare e bordit të Galerisë Kombëtare të Arteve në vitin 2018. Jeton dhe punon në Tiranë.

FIDEL YLLI, ROBERT NDRENIKËS: PSE NUK I KËRKOVE BERISHËS TEATËR TË RI KUR ISHE DEPUTET I PD-së?

Dalja në mbrojtje të Teatrit Kombëtar i ka kushtuar shumë Ndrenikës. Jo vetëm që si kurrë më parë, ai del në media çdo të hënë të flasë për teatrin, por kundër tij kanë folur edhe disa figura publike. Pas letrës së hapur të Mirela Kumbaros për të, vjen një tjetër pyetje publike. Ka qenë deputeti i Partisë Socialiste Fidel Ylli, që teksa ka folur mbi prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar dhe ndërtimin e një të riu, nuk ka kursyer as Ndrenikën.

Ai tha se qeveria nuk e ka mundësinë që të ndërtojë një godinë të shtrenjtë, duke shtuar se në këto kushte nuk mund t'i lërë aktorët të luajnë në një ndërtesë që po shembet.

Nga "Faxnews", Ylli ka sulmuar edhe aktorin e madh Robert Ndrenika të cilin e ka

pyetur se "Pse nuk i kërkove Berishës godinë të re kur ishe deputet i PD-së?""Do të bëhet një teatër bashkëkohor, europian dhe pa kullë. Po deklaroj me përgjegjshmëri si sekretar i Komisionit Parlamentar të Edukimit dhe Medias se qeveria deri tani nuk ka marrë asnjë vendim. Çdo vendim do të merret në transparencë. Ka vetëm një ofertë që po shqyrtohet ligjërisht",-tha Ylli.

Opinioni i Ditës

Evropa, politika dhe populizmi

Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... të brendshëm dhe zgjerimit të jashtëm, BE-ja po ndeshet edhe me sfidën serioze të përshkallëzimit të forcave dhe partive populiste, këto të fundit po kërkojnë "të bëjë ligjin" edhe në vendet me demokraci të konsoliduar - Britania e Madhe, Franca, Austria, Gjermania, Spanja, Greqia dhe gjetkë. Ndërsa në vendet e ish-Evropës Qendrore dhe Lindore, "Internacionalja komuniste" e dikurshme po zëvendësohet me një "Internacionale populiste" së bashku me homologët e tyre perëndimorë. Vërtet që populizmi dështoi vjet në Francë, por gjithsesi nuk ka hequr dorë nga tentativat e tij, por ai fitoi bujshëm në Austri dhe së fundi në Itali, ku të tri partitë populiste (Pesë Yjet, Lega Nord dhe Forca Italia) fituan 64 për qind të votave. Po kështu, "Alternativa për Gjermaninë" (AfD) u fut për herë të parë në Bundestag si forca e tretë më e madhe politike, me plot 22 për qind në zgjedhjet e fundit, ajo la pas të majtën tradicionale në ish-lindjen Gjermane dhe ka gërryer ndjeshëm pjesën e CSU-së në shtëpinë e saj në Bavari.

Ja pse lufta ndaj populizmit përbën një nga betejat më madhore të kohës në çdo vend dhe në nivel evropian. Edhe Shqipëria nuk mund të mbetet jashtë kësaj sfide, pasi shfaqjet populiste nuk mungojnë as aty.

Suksesi në përballimin e kësaj sfide kërkon së pari ndërgjegjësimin e politikës dhe të publikut mbi tiparet specifike dhe dëmet e populizmit.

Sipas profesorit dhe ekspertit belg të kësaj fushe, Alain Eraly, burimi i parë i populizmit është nostalgjia konservatore, pra ideja se kemi qenë më mirë dhe për pasojë ndjenja e viktimizimit. Sipas politikanëve populistë, populli është viktimë e elitave politike dhe qeveritare. Ky viktimizim shoqërohet me shfaqjen e ndjenjave nacionaliste, të gjoja tradhtisë ndaj popullit, cenimit të territoreve, krenaria me kombin etj. Në Belgjikë psh., ata pretendojnë se kërcënimi i sigurisë vjen nga emigrantët dhe azilkërkuesit, apo se "islami është kërcënim për historinë tonë", etj.

Në fakt, populizmi dhe ekstremizmi i djathtë, sidomos në Gjermani, Austri, Hungari, Belgjikë dhe gjetkë mori hov pikërisht në vitet 2015-2016 pas valëve masive të azilit, që përkuan me zgjedhjet e reja parlamentare.

Liderët populistë nuk shquhen nga mendimet që shprehin, por nga stili dhe retorika e tyre; për ta nuk ka rëndësi ideja, por mënyra si shprehet ajo, jo çfarë por si të thuhet, jo zgjidhja por provokimi i problemit dhe së fundi, jo faktet, por e vërteta e tyre subjektive. Kështu, ndonëse në Gjermani gjatë tri viteve të fundit kriminaliteti ka shënuar rënie dhe niveli i tij nga vetë gjermanët është më i lartë se ai i të huajve, populistët as që duan t'ia dinë dhe vazhdojnë

retorikën nacionaliste të shoqëruar me frikë dhe mohim.

Shkaku dhe dukuria e dytë e përhapjes së populizmit është kulti dhe karizma e liderëve të tij, aftësia bindëse që në "emër të demokratëve të hedhim poshtë burokratët", të luftojnë deri në fund të këqijat më të mëdha të kohës së sotme - elitat politike, BE-në e sidomos Brukselin, Bankën Qendrore Evropiane, FMN dhe Bankën Botërore etj.

Kryeministri Viktor Orbani korri fitoren e katërt plebishitare në zgjedhjet e fundit në Hungari në emër të mbrojtjes së Hungarisë, edhe pse ajo është anëtare e NATO-s dhe e BE-së. Në Britaninë e Madhe "Brexit" e bashkë me të populizmi fituan me parullën "Anglia për anglezët".

Këta liderë karakterizohen nga gjuha vulgare dhe banale, sipas parimit "të thuash açik dhe me zë të lartë atë që të tjerët e mendojnë dhe e thonë me zë të ulët". Kësisoj, ata synojnë të krijojnë imazhin e politikanit të sinqertë, që është "njeri prej nesh", në mënyrë që jo thjesht të tërheqë, por të "pushtojë" të gjithë vëmendjen dhe interesin mediatik.

Ata e teprojnë dhe mohojnë çdo të mirë dhe arritje, duke treguar gishtin vetëm te mungesat dhe mangësitë e sistemit demokratik sipas tyre "katastrofal", por kur vjen puna te zgjidhja e problemeve që janë tejet komplekse, ata i thjeshtëzojnë ato në minimum, pa hyrë në hollësi teknike. Kështu, ata mendojnë se problemi i drogës do të zgjidhet duke pushkatuar pa gjyq trafikantët e paligjshëm, duke mos paguar asnjë cent për refugjatët apo dhe duke propozuar hedhjen e tyre në det!

Veç sa sipër, suksesi i shpejtë i politikanëve populistë shpjegohet me zhgënjimin masiv me klasat politike ekzistuese dhe sidomos me qendrën e majtë dhe të djathtë, që kanë drejtuar tradicionalisht këto vende, sepse me gjithë premtimet, gjërat kanë shkuar keq e më keq. Në fakt, sondazhet më të fundit të eurobarometrit tregojnë se vetëm 44 për qind e shtetasve evropianë kanë besim te BE-ja; në vende të veçanta, mosbesimi është edhe më i lartë. Këtu kanë pjesën e tyre dhe skandalet/aferat e shumta korruptive. Mbi këtë bazë, politologu britanik Paul Taggart pohon se "opozita ndaj pushtetit përfaqësues përbën thelbin e populizmit".

E fundit, por shumë e rëndësishme është ndikimi negativ i medias, sidomos i rrjeteve sociale që kanë "robëruar" dhe qelizat më intime të jetës.

"Infobesiteti" ose "mbipesha" nga informacioni hiperinflacionist është bërë "epidemi", sidomos te rinia. E keqja është se këto informacione që "gëlltiten" pa u "përtypur" fare, orientohen drejt emocioneve dhe jo arsyetimit logjik; adoleshentët, në veçanti nuk kanë minimumin e kohës që të reflektojnë mbi çka shohin dhe dëgjojnë dhe ca më pak të krijojnë distancën e nevojshme për gjykimin dhe analizën e lajmeve apo ngjarjeve me të cilat njihen. Për pasojë, lind dhe përhapet tendenca e parapëlqyer e populistëve për shpjegimin e thjeshtësuar të ngjarjeve me teori konspirative, të komplotit, tradhtisë etj., duke shpurë kështu "ujë në mullirin populist".

Shumica e analistëve dhe ekspertëve mendojnë se lufta dhe fitorja ndaj populizmit fillon nga familja dhe prindërit, sepse qysh fëmijë njerëzit lipset të edukohen me ndjenjën e kërkimit të së vërtetës objektive nëpërmjet forumeve, debateve dhe diskutimeve të gjalla dhe analizave përkatëse.

Sondazhet më të fundit tregojnë gjithashtu se arsimi, shkollat, OJQ-të dhe agjenci të tjera kulturore me nismat e tyre kanë rol të dorës së parë për nxitjen e frymës/kulturës së gjykimit dhe arsyetimit, bërjes së pyetjeve dhe shprehjes së dyshimeve mbi çdo informacion dhe për gjithçka që lexojnë dhe dëgjojnë fëmijët dhe të rinjtë që të mos bien pre të internetit dhe rrjeteve sociale. Në Bruksel, për shembull, një qendër kulturore nën logon "Fabrika e Demokracisë" organizon debate dhe diskutime me fëmijë dhe të rritur mbi tema intriguese të aktualitetit tonë. Padyshim që shembull i spikatur dhe inkurajues është dhe fushata publike "Be Best" e lançuar pardje nën kujdesin e Zonjës së Parë të SHBA-ve, Melanie Trump.

Si kudo dhe këtu, politika ka rolin e saj vendimtar duke miratuar dhe zbatuar ligjet dhe rregullat e duhura, duke lançuar alternativa tërheqëse, të besueshme dhe të qëndrueshme dhe duke u dhënë zgjidhje halleve të përditshme të njerëzve, etj.

Së fundi, por jo më pak të rëndësishme janë metodat politike efektive që përdorin forcat e moderuara politike. Politologu i njohur holandez Cas Mudotte tërheq vëmendjen se "ashtu siç nuk mund të shuhet zjarri me zjarr, edhe populizmi nuk mund të luftohet me populizëm".

Natyrisht, mund të përdoren nuanca dhe slogane populiste si taktikë e përkohshme, por jo si strategji veprimi. Këtë e tregon edhe pritja e ftohtë dhe kundërshtitë e shumta që shkaktuan disa hapa dhe teza të liderëve të CSU-së bavareze, partnere qeveritare e Merkel se, "Islami nuk i përket Gjermanisë"», "emigrantët na kanë vjedhur vendlindjen" dhe vendimi për vendosjen e kryqit në institucionet zyrtare "si simbol i identitetit bavarez".

Mbi të gjitha, premisat e suksesit të vërtetë mbi populizmin qëndrojnë te lufta kundër korrupsionit dhe krimit, zgjidhja e krizës së azilit, afrimi me popullin, mbi të gjitha sjellja politike me "këmbë në tokë" e politikanëve dhe deputetëve dhe moderimi i "real politikës". Kjo e fundit u ka ardhur vërtetë "në majë të hundës" një pjese të madhe të publikut.

Fushata e zgjedhjeve për Parlamentin e ri Evropian 2019, që pritet të "ndezë së shpejti motorët" në të 27-ta vendet anëtare të BE-së është mundësia e parë madhore dhe e "artë" për të bërë kthesën e kërkuar dhe rikthyer besimin e humbur te politika e re.

Ndoshta ka të drejtë, eksperti Philippe Legrain, këshilltar ekonomik i ish-presidentit të Komisionit Evropian Barroso, i cili ka propozuar një "Pranverë Evropiane", që BE-ja të mos vazhdojë të jetë më kod i bezdisshëm rregullash se "çfarë nuk duhet bërë", por një projekt frymëzues me logon "Ta bëjmë Evropën sa më të mirë së bashku dhe për qytetarët".

HOROSKOPI

DASHI

Bashkëveprimi i planetëve do të bëjë që humori juaj të ketë luhatje. Mos u mbyllni brenda vetes. Pranoni dhe besojuni të tjerëve. Për të arritur në një mirëkuptim më të madh, vëreni veten në vendin e partnerit dhe bëni më të mirën që mundeni.

DEMI

Edhe pse dini të manovroni më së miri duke u mbështetur në vetvete, mos e refuzoni ndihmën që do t'ju vijë nga një mik. Do të kërkoni dhe do të gjeni, me Marsin dhe Venusin që ju mbështesin, mundësi dialogu dhe bashkëpunime me personin e dashur.

BINJAKET

Do të jeni të frymëzuar për të mposhtur çdo mendim shkatërrimtar, do të përvishni mëngët dhe do të përmbushni me zell punët tuaja. Në fillim kush ju intereson do t'i përgjigjet ftesës me droje, por më pas do të dorëzohet nga sharmi i juaj.

GAFORJA

Me Saturnin që e keni kundra, mos flisni shumë në ambientin e punës. Mos krijoni konfidenca. Mundohuni të mos tregoni sesi ndiheni. Mos u ndruani dhe thoni ato që ju thotë zemra, edhe pse keni frikë se personi i dashur përkrah jush mund të mos ju kuptojë.

LUANI

Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni kështu vlerësimin e një eprori.

VIRGJERESHA

Keni shumë pritshmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte më mirë të përqendroni vëmendjen diku tjetër. Mos u bëni kokëfortë! Keni dëshirë të madhe të imponoheni në të gjitha rrethanat. Do të ishte mirë që të mendoheshit pak.

PESHORJA

Nëse në jetën e në çift xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepini fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejtim. Plutoni nuk shkon mirë me Saturnin! Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

AKREPI

Partneri më në fund do të jetë një lartësinë e duhur që kërkon situata dhe nuk do të shqetësohet nga përgjigjet që do t'u jepni kërkesave që ka. Nëse do të zgjidhni të jeni më emocional, do të jeni më pak bujar dhe të përfshirë, por me siguri më të qartë dhe të qetë.

SHIGJETARI

Sot mund t'ju dalin gjëra të paparashikueshme. Për të shmangur tensione, ndiqni atë që ju thotë zemra, edhe pse mund të interpretohet si një dobësi. Do të keni një ditë që priret drejt përtacisë, por që nuk pajtohet me angazhimet tuaja të shumta.

BRICJAPI

Disa kërkesa për pushtet në çift nuk funksionojnë. Hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që hanë diskutim. Duke këmbëngulur do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

UJORI

Nëse keni programuar një udhëtim, do ta menaxhoni më mirë lodhjen dhe përshtatjen ndaj ritmeve më të mëdha të punës, me Plutonit mik që ju favorizon. Kridhuni në ndonjë aventurë të bukur, zbuloni një horizont të ri dhe jetojeni me gjithë shpirt.

PESHQIT

Ditën e sotme përpiquni ta shfrytëzoni çastin e mirëqenies shpirtërore për të dëgjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes. Me Saturnin që ju del kundra, priten disa përgjegjësi që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirinë.

Opinioni i Ditës

Diplomacia "jounike" e Kosovës

Nga Nadie Ahmeti

(vijon nga faqja 1)

... të mëdha për vendin. Analisti Imer Mushkolaj, thotë se çështjet shtetërore duhet të jenë unifikuese, në mënyrë institucionale dhe jo në mënyrë personale. "Politika e jashtme e vendit dhe në përgjithësi institucionet, për fat të keq kanë vuajtur nga mungesa e koordinimit në raste të caktuara, qoftë kur bëhet fjalë për numrin e njohjeve, qoftë qasjen institucionaliste, që vendi duhet ta ketë. Shumë nga çështjet janë trajtuar më shumë në rrafshin personal sesa në rrafshin institucional. Natyrisht se kjo është e dëmshme për vendin dhe nuk duhet të ndodhte kështu", tha Mushkolaj. Një shembull i mungesës së qëndrimeve unike dhe harmonizimeve në politikën e jashtme është vërejtur këto ditë, kur shefi i diplomacisë së Kosovës, Behgjet Pacolli mori pjesë në një konferencë ministrore të vendeve të Organizatës se Bashkëpunimit Islamik, të mbajtur në Bangladesh. Një nga tri objektivat e pjesëmarrjes në këtë konferencë, sipas Pacollit ishte edhe "aplikimi i Kosovës për statusin e vendit vëzhgues në këtë organizatë". Në anën tjetër, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Gjergj Dedaj, ka paralajmëruar dorëheqje të parevokueshme, nëse Kosova anëtarësohet në këtë organizatë, siç tha ai, pa një debat në Kuvendin e Kosovës dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në një bisedë për Radion Evropa e Lirë, Dedaj tha se kjo nuk ka të bëjë me kundërshtimin e politikës së ministrit Pacolli, apo për çfarëdo polemike tjetër ndërfetare në Kosovë, por që sipas tij, agjenda kryesore në Kosovë është miqësia dhe partneriteti me SHBA-të, anëtarësimi në NATO dhe integrimi sa më parë në Bashkimin Evropian. "Unë si zëvendësministër i Jashtëm në Qeverinë e Kosovës mbetem ithtar i respektimit të agjendave dhe prioriteteve të Kosovës. Dhe për ne, agjendë, prioritet është anëtarësimi i Kosovës në

Bashkimin Evropian, NATO, INTERPOL, UNESCO dhe në të gjitha institucionet tjera, të cilat nuk kanë premisa prefikse apo fikse, qofshin ato islamike apo krishtere. Sepse, Kosova nuk e ka atë luks për shkak të përbërjes dhe strukturës konfesionale në Kosovë, që t'i vëmë agjendat para anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian", tha Dedaj. Në anën tjetër, Emrush Ujkani, profesor i të Drejtës Evropiane tha për Radion Evropa e Lirë se deklaratat e tilla kontradiktore nuk sjellin efekte pozitive në ecjen përpara të shtetbërjes së Kosovës dhe njohjes së saj në arenën ndërkombëtare. "Kjo tregon më së miri se sa ka koordinim në institucionet relevante. Në konferencën e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik ka mysafirë edhe nga vendet tjera të botës dhe nuk duhet të shikohet me një sy kritik". "Ka vende që e kanë njohur Kosovën dhe Kosovës i nevojitet bashkëpunim edhe më këtë organizatë. Kjo nuk do të thotë integrim në të, por për të kërkuar mbështetjen e kësaj organizate", theksoi Ujkani. Ndërkaq, Imer Mushkolaj, thotë se deklaratat, siç ishin ato të zëvendësministrit Dedaj, mund të përcillen me efekte të dëmshme për Kosovën në planin e jashtëm. Sipas tij, Kosova si shtet duhet ta përcaktojë qartë në politikën e jashtme se në cilat organizata do të duhej të anëtarësohet dhe në cilat jo. "Në anën tjetër duhet parë interesin nëse anëtarësimi në ndonjë organizatë që mund të mos jetë e orientuar kah vlerat euroatlantike mund t'i sjellë dobi vendit, në kuptimin e njohjeve dhe në kuptimin e bashkëpunimit. Tek e fundit Kosova nuk mund të funksionojë e izoluar. Bashkëpunimi më çfarëdo organizate që mund t'i sjell dobi vendit duhet të jetë i mirëseardhur", tha Mushkolaj. Edhe në të kaluarën janë vërejtur disa paqartësi te politika e jashtme e Kosovës dhe numri i njohjeve ndërkombëtare. Deri vonë, institucionet e ndryshme prezantonin shifra të ndryshme rreth numrit të njohjeve. Por, tash për tash, kjo çështje është tejkaluar. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, thuhet se "Republika e Kosovës ka siguruar 116 njohje" dhe se "njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e sovranitetit të Kosovës do të mbetet prioritet i Ministrisë së Punëve të Jashtme".

Reportazhi i Ditës

Sa e vështirë të jesh ndryshe…

(Historia e Rudinës dhe Manuelit, World Vision në ndihmë të fëmijëve)

Nga Elira Çanga

Rudina nuk ka shkuar në shkollë sot. Portreti fëminor shfaqet me nxitim pas supeve të nënës së saj, Mirandës, ndërsa na fton të hyjmë në shtëpinë njëkatëshe të familjes në fshatin Babje të Librazhdit.

Duhen më shumë se 30 minuta me makinë nga qyteti, nëpër një shteg anash kodrës, për të mbërritur në shtëpinë e familjes Qoshku. Elvisi, babai i Rudinës, është gjithnjë në kërkim të punës, ndërsa nëna rrit katër fëmijët e familjes, pothuaj pa asnjë ndihmë.

"Rudina kujdeset shumë për të vëllanë, është më e kujdesshmja nga të tri motrat", tregon Miranda, duke treguar me dorë një bebe fare të vogël që fle shpenguar në karrocën në qendër të kuzhinës.

Rudina e mbulon me kujdes, duke e përkëdhelur. "Ndoshta sepse është më e madhja, ka gjithnjë dëshirë ta mbrojë atë",- thotë e ëma.

Rudi, tashmë 13 vjeç, duket e hutuar, por ka një shikim kurioz e të ëmbël. Ajo ka vështirësi në të folur dhe në shikim. Që në moshë të vogël është diagnostikuar me paralizë faciale centrale dhe miopi të lartë.

"Ka qenë gjithnjë një fëmijë i qetë. Në moshën 18 muajsh pati një temperaturë të lartë, si pasojë e një gripi të zgjatur. Nxituam ta çonim në spitalin e Librazhdit, me zor gjetëm një makinë e me nxitim arritëm në spital. Mjekët na thanë se temperatura e lartë kishte shkaktuar goditjen cerebrale, si pasojë edhe atë faciale. Me kalim e kohës kuptuam se vajza kishte edhe vështirësi në shikim",-tregon nëna e saj me lot në sy.

Për Rudinën, nuk është aspak e lehtë të jesh ndryshe nga të tjerët, ndaj është e mbyllur në vetvete. Megjithatë ajo shkon në shkollë bashkë me të dy motrat më të vogla, Fjorin dhe Aidën.

Ishte mësuesja e saj ajo që i rekomandoi familjes ta dërgojë Rudinën në qendër, ku mund të marrë trajtim fizioterapie.

"Nuk ka shumë shoqëri, por ka dëshirë të shkojë në qendër",-tregon nëna e saj.

"Puna është se jo gjithnjë kemi mundësi ta çojmë. Im shoq herë punon e herë jo e unë jam vetëm me katër fëmijët, gjë që e bën shpesh të pamundur ta shoqëroj e ta pres pas trajtimit".

Terapia në shtëpi që World Vision përmes programit social "Tungjatjeta Jetë" do t'i krijojë asaj mundësinë që ta ndjekë atë dy herë në javë nën kujdesin e Dorelës dhe Suadës, te specializuara për fizioterapi dhe logopedi.

"Do të ketë një vlerësim të plotë të gjendjes së saj aktuale. Më pas do të ndjekim të gjithë hapat e duhur në mënyrë që Rudina të ketë sa-

dopak përmirësim", shpjegon me qetësi Dorela, një nga specialistet e ekipit të "Tungjatjeta Jetë".

Miranda rrëfen se jeta e saj është e mbushur me vështirësi, por se momentet më të bukura janë ato të kaluara me fëmijët. "Jetojmë me një asistencë prej 5700 lekësh në muaj, që nuk janë mjaftueshëm. Unë arrij të blej vetëm gjërat më të domosdoshme në shtëpi. Rudina ka nevojë për ndihmë gjatë 24 orëve",-rrëfen Miranda e përlotur.

HISTORIA E MANUELIT

Në Semës, jo shumë larg Librazhdit, derën e shtëpisë e hap Manueli bashkë me nënën e tij.

Ai nxiton të të tërheqë brenda shtëpisë dhe më pas nis të vrapojë brenda dhomës pa pushim. Është pesë vjeç dhe është diagnostokuar me autizëm infantil në/moshën 2-vjecare.

Nëna e tij, Dhurata, është e shqetësuar për të ardhmen. Ajo e ndjek nga pas me një vështrim të dëshpëruar ndërsa vogëlushi vrapon në dhomën e vogël.

"Manueli është një fëmijë shumë energjik, nuk pushon një sekondë dhe e ka të vështirë të përqendrohet qoftë edhe për pak", rrëfen ajo. Manueli nuk komunikon me fjalë, por me gjeste. Shpeshherë ai është nervoz, por nëna e tij përpiqet ta qetësojë.

"Shoh që ka ndryshim tashmë që po bën terapi logopedike, por ai ka nevojë ta vazhdojë këtë", pohon e ëma. "Nuk është e lehtë me të, por shoh se, nëse më parë nuk ishte aspak i qetë, tashmë ai mund të përqendrohet për pak minuta".

Manueli ka bërë edhe më parë terapi logopedike në qendrën "Fluturo për jetën" në Elbasan, por për shkak të kushteve ekonomike, familja e pati të pamundur ta vazhdojë atë. Nëna e Manuelit nuk punon, ndërsa babai shkon çdo 3 muaj në Maqedoni në kërkim të një pune dhe të ardhurave për të mbajtur familjen, e cila ka edhe një vajzë më të vogël. Manueli nuk ndalon së vrapuari në shtëpi dhe vazhdimisht kërkon vëmendje. "Është hiperaktiv" tregon nëna e tij, e cila këmbëngul se dërgimi në qendër për logopedi do të ndihmonte atë të mësohej me një mjedis të ri, pasi në shtëpi nuk ka më asnjë kuriozitet.

Familja jeton në kushte shumë të vështira por ka një dëshirë të vetme, që vogëlushi të jetë më i qetë dhe zhvillimi i tij të jetë i qëndrueshëm.

"Tungjatjeta Jetë" është një program social, i cili po mbështet këta fëmijë me shërbime jetike për shëndetin, por edhe të ardhmen e tyre.

"Tungjatjeta Jetë", ka nisur më 6 prill në zonat më të thella të Librazhdit. Ekipi lëvizës, i cili përbëhet nga një fizioterapist, një logopedist, një psikolog dhe një punonjës social do t'iu japë 35 fëmijëve me aftësi të kufizuara shërbimet për të cilat ata kanë nevojë në shtëpi.

Por pse është domosdoshmëri "Tungjatjeta"?

Në të gjithë vendin numërohen 70 mijë fëmijë me aftësi të kufizuar dhe vetëm 7.8 % e tyre marrin shërbime të specializuara.

Studimi për prevalencën e aftësisë së kufizuar në Shqipëri tregoi se arsyet kryesore të mosndjekjes së shërbimeve sociale sipas prindërve janë, mospërballimi i kostove financiare që lidhen me shërbimet, 20% kanë si problem transportin, 8.9% shprehen se kanë mungesa të shërbimit në komunitet, 11.1 % nuk iu është mundësuar shërbimi, dhe 8.9 % shprehen se cilësia e shërbimeve është e papërshtatshme.

Vajza: I dashuri është xheloz, nuk kishte probleme me shokët e universitetit

Sherr me thika para Presidencës, plagosen 4 studentë, arrestohet 20-vjeçari Henri Karaj

Shkak për përplasjen mes të rinjve, e dashura e autorit

Ina Allkanjari

Një sherr verbal mes një grup të rinjsh ka përfunduar në plagosje me thikë mesditën e djeshme në kryeqytet. Në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë, rreth orës 11:40 të së martës, 4 studentë të moshës 18-19 vjeç mbetën të plagosur. Ngjarja ka ndodhur në trotuarin pranë Pallatit të Kongreseve dhe selisë së Presidencës dhe shkak i konfliktit mësohet të ketë qenë një vajzë, e cila mendohet të jetë e dashura e autorit. Të rinjtë janë studentë të vitit të parë të Universitetit Politeknik të Tiranës. Konkretisht personat, të cilët mbetën të plagosur janë Jurgen Lleshi 18 vjeç, kushëriri i tij Feliks Lleshi 18 vjeç, Klajdi Dumi 19 vjeç dhe Klajdi Marku 19 vjeç. Të plagosurit u transportuan menjëherë në spital, ku po kurohen dhe janë jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë uniformat blu vunë në pranga autorin e ngjarjes, i cili mësohet të jetë Henri Karaj, 20 vjeç, banues në Tiranë. Ai u shoqërua në komisariat dhe po merret në pyetje lidhur me ngjarjen në fjalë.

KONFLIKTI

Mesditën e djeshme u krijua një situatë paniku në një zonë të populluar siç është bulevardi përballë Presidencës, ku kalimtarë të shumtë u bënë spektatorë të një sherri masiv me thika që solli 4 të plagosur. Mësohet se sherri ndodhi për një vajzë, pasi njëri prej katër të plagosurve kishte ngacmuar një ditë më parë të dashurën e autorit pranë godinës së rektoratit të Universitetit Politeknik në Tiranë. Të rinj e kishin lënë të sqaronin këtë të martë ngacmimin dhe sherri degradoi në përdorimin e thikës. Autori i ngjarjes Henri Karaji, cili përfundoi në pranga, mendohet se u ndihmua nga 2 persona të tjerë. Ndërkohë të plagosur mbetën Jurgen Lleshi, kushëriri i tij Feliks Lleshi, Klajdi Dumi dhe Klajdi Marku. Burime nga hetimet thanë se Karaji qëlloi fillimisht njërin prej të rinjve, ndërsa të tjerët u plagosën në tentativë për të ndarë konfliktin. Të plagosurit u shoqëruan për në spital dhe pas përmirësimit të gjendjes shëndetësore do të nisë procesi i marrjes në pyetje. "Kapet dhe arrestohet në kohë rekod autori i plagosjes së katërfishtë të ndodhur ditën e sotme në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Arrestohet nga shërbimet e policisë Tiranë, shtetasi: Henri Karaj, 20 vjeç, banues në Tiranë. Pas një konflikti për motive të dobëta, Henri Karaj plagosi me mjet prerës shtetasit J. Ll., 18 vjeç F. Ll., 18 vjeç K., D., 19 vjeç dhe K. M., 19 vjeç", sqaroi policia. Ndërkohë vajza për të cilën ndodhi sherri është marrë në pyetje nga policia dhe ka deklaruar se i dashuri ishte xheloz dhe se nuk kishte probleme me shokët e universitetit. Sakaq materialet iu referuan prokurorisë për veprime të mëtejshme hetimore për veprën penale të plagosjes me dashje.

Policia në vendngjarje

KONFLIKTI

Në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë, rreth orës 11:40 të së martës, 4 studentë të moshës 18-19 vjeç mbetën të plagosur. Shkak i konfliktit mësohet të ketë qenë një vajzë, e cila mendohet të jetë e dashura e autorit, 20-vjeçarit Henri Karaj.

Shkaku

PLAGOSJA E ÇIFTIT

Vetëm pak ditë më parë në kryeqytet një 27-vjeçar dhe e fejuara e tij mbetën të plagosur pasi tre persona qëlluan me thikë mbi ta. Sipas dëshmisë që dhanë pas arrestimit, shkak i sherrit ishte fakti se njëri prej autorëve kishte qenë i fiksuar me 23-vjeçaren, e cila po jetonte një lidhje dashurie me djalin që e shoqëronte në momentin e plagosjes.

STUDENTËT E PËRFSHIRË NË SHERR

Henri Karaj	20-vjeç
Jurgen Lleshi	18-vjeç
Feliks Lleshi	18-vjeç
Klajdi Dumi	19 vjeç
Klajdi Marku	19-vjeç

Shpërndanin kokainë në kryeqytet, bien në pranga 4 persona

TIRANE- Katër persona kanë rënë në pranga ditën e djeshme, pasi ishin përfshirë në një grup të tregtimit të kokainës. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se në kuadër të operacionit "Avangarde" u arrestuan Gëzim Kovaçi, 46 vjeç, Flobenc Kurti, 30 vjeç, Artur Nikoçi, 23 vjeç si dhe Muharrem Bakalli, 38 vjeç, banues në Tiranë. Mësohet se të arrestuari merreshin me shitblerje të lëndës narkotike të llojit Kokainë në zona të ndryshme të kryeqytetit. Trafikantëve iu sekuestruan 217 gramë lëndë narkotike e dyshuar e llojit kokainë, 2 automjete, 4 aparate celularë dhe 1 peshore elektronike. Shtetasit e mësipërm ishin në ndjekje nga shërbimet e policisë, pasi për ta disponohej informacion se merreshin me shitblerje të lëndës narkotike të llojit kokainë në zona të ndryshme të kryeqytetit dhe në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, 4 shtetasit e lartpërmendur janë konstatuar nga shërbimet e policisë duke u takuar së bashku në zonën e "Fushës së Aviacionit" dhe gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin tip "Golf" me drejtues shtetasin Artur Nikoçi dhe pasagjer Flobenc Kurti është gjetur një paketim i mbështjellë me natriban brenda të cilit kishte lëndë narkotike të dyshuar e llojit kokainë si dhe një peshore elektronike. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për veprime të mëtejshme hetimore për veprën penale "Prodhim dhe shitje të lëndës narkotike e kryer në bashkëpunim".

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e Blu Diesel dhe benzine pa plumb 95 oktan, për nevojat e Bankës se Shqipërisë ne Tirane dhe ne dege"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 20.000.000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërhequja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje e Blu Diesel dhe benzine pa plumb 95 oktan, për nevojat e Bankës se Shqipërisë ne Tirane dhe ne dege"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 31 Maj 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotuaret.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Eshtë përfaqsuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nyja që preu Alekdansdri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL
1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Fillojnën panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshtë nginjja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.
35. Mbyllin një ditar.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

VERTIKAL
1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicilat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshtë trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

	8			2			4	
		3	5		7	6		
5			6		8			1
2	7						9	5
		4				7		
1	6						2	4
9			2		3			8
		5	1		4	9		
	4			8			5	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	1	3	4	8	6	5	7	9
7	9	8	3	1	5	4	2	6
4	5	6	9	7	2	8	3	1
3	6	4	1	5	8	2	9	7
9	7	5	6	2	3	1	4	8
1	8	2	7	9	4	3	6	5
5	2	7	8	4	9	6	1	3
6	4	9	5	3	1	7	8	2
8	3	1	2	6	7	9	5	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Nëse doni që diçka të realizohet shkoni vetë, nëse nuk doni, dërgoni të tjerë. **(Benxhamin Franklin)**
- Fundi i madh i jetës nuk janë njohuritë, por veprat. **(Tomas Fuller)**
- Njeriu që vepron qëndron më pranë njerëzve se sa njeriu që shkruan dhe është në dorën e njerëzve që idetë e reja, të përkthehen në gjuhën e ashpër të veprave. **(Rudru Uillson)**

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	T	R	I	P		B	B		V	O	T	A
	H	E	R	O	I	N	A		O	V	E	R
S	A	S		S	N		R	V			R	T
U	T		S	H	T	E	T	E	R	O	R	E
B		L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	T
	M	I	N	E	R	A	L	E	T		C	
K	A	L	O	R	E	S	I	T		H	A	V
	C	A	R	I	S	T		I	N		T	L
V	H		I	M		I		M	I	K		E
R	A	M			E	T	N	A		A	R	R
A	D	R	E	S	E		I	T	A	L	I	A
P	O	L	E	M	I	K	A		S	E	A	T

Thënie të mençura

Faik Konica:
- Nuk mund të gjykohet për tokën para se të mbjellësh (domethënë: toka e mirë njihet kur hedh farën (Albania, 31 maj 1901).
- Shumë broçkulla edhe u falen politikanëve, por pa kaluar kufijtë (Albania 20 qershor 1901).

Jorge Luis Borges:
- Koha është lënda prej së cilës unë jam bërë. Koha është një lum që më merr mua me vete, por unë jam lumi; është një tigër ai që më përlan mua, por unë jam tigri; është një zjarr ai që më shkrumbon mua; por unë jam zjarri.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

M	A	T	A					H	E	L	M	E	T	
A	R	R		V	E	D		D	E	P	P		P
	P	A	R	A	L	E	L	E	T		L	E	R
		P	O	L	I	F	E	M	I		O	L	E
E	M	I	L	E	Z	O	L	A		E	T	I	K
L	A		I	R	A	E			R	R	E	Z	E
E	R	A		I	B		E	M	R	I		I	S
H	I		M	A	E	S	T	R	O		D		E
T	A	L	E	N	T	E	T		T	A	R	E	
E		K	R	A	H		O	R	A	R	I		A
	S		I			P	R	I	T	A	T		R
K	A	P	A	N	O	N	E	T		L	A	L	A

FJALEKRYQI (2)

D	I	S	K	O	T	E	K	A	T			A	P
R	O	M	A	N			A	R	G	O	S		A
E	N		T		G	N		I		R	H		R
W		M	O	N	O	G	R	A	F	I	A		A
	P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T		I	D	E
A	L		K	R	A	H	E	T		K	S	H	
K	E	N		I	T	T			K	A	T	E	T
E	M	I	L	E		E	N	J	O	M	E		R
T	I	M	E	R		S	T	A	N	E	T		I
A	K		S	E	R	I	O	Z		R		A	M
T	E	O		T	R	A		Z	J	A	R	R	I

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!